

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 7 numër 18 dhjetor 2005

Data e botimit 12.01.2006

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.97, datë 28.12.2005 "Për miratimin e "Raportit të Politikës Monetare për muajin nëntor të vitit 2005""	5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.99, datë 28.12.2005 "Për miratimin e "Dokumentit të Politikës Monetare për vitin 2006""	22
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.101, datë 28.12.2005 "Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të "Bankës Union sh.a.""	33
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.102, datë 28.12.2005 "Për miratimin e udhëzimit "Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve të punës së subjekteve që licencohen nga Banka e Shqipërisë""	34
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.103, datë 28.12.2005 "Për miratimin e rregullores "Për nënshkrimet e autorizuar dhe kufijtë e pagesave në Bankën e Shqipërisë"."	46
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.104, datë 28.12.2005 "Për miratimin e "Kalendarit të mbledhjeve dhe programit të punës së Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për vitin 2006""	53
Ndreqje gabimesh	55
7. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 1, Shkurt 2005	56
8. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 2, Shkurt 2005	56
9. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 3, Shkurt 2005	56
10. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 4, Prill 2005	56
11. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 5, Prill 2005	57
12. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 6, Maj 2005	57
13. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 7, Maj 2005	57
14. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 8, Qershor 2005	58
15. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 9, Qershor 2005	58
16. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 10, Korrik 2005	58
17. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 11, Gusht 2005	59
18. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 12, Shtator 2005	59
19. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 13, Tetor 2005	59
20. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 14, Nëntor 2005	59
21. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 15, Nëntor 2005	60
22. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 16, Nëntor 2005	60
23. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 17, Dhjetor 2005	60



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.97, datë 28.12.2005

PËR
MIRATIMIN E "RAPORTIT TË POLITIKËS MONETARE PËR MUAJIN NËNTOR
TË VITIT 2005"

Në mbështetje të nenit 43, shkronja "ç" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997
"Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Politikës
Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Raportin e Politikës Monetare për muajin nëntor të vitit 2005",
bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare me dërgimin e këtij raporti
në: Kuvendin e Shqipërisë, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e
Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian
dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

YLLI MEMISHA

KRYETARI

ARDIAN FULLANI

I. ZHVILLIMET KRYESORE

- Inflacioni vjetor në muajin nëntor shënoi vlerën 3.0 për qind, duke u luhatur në mesin e objektivit 2–4 për qind të Bankës së Shqipërisë.
- Inflacioni vjetor u ndikua nga rritja e çmimeve të energjisë dhe të lëndëve djegëse, e çmimit të qirasë së banesave si dhe të naftës. Thellimi i krizës energjitike në muajin nëntor ndikoi në rritjen e kërkesës për burime zëvendësuese të energjisë, duke ushtruar presion për rritjen e çmimit të tyre.
- Presionet inflacioniste janë zbutur nga politika e kujdesshme fiskale dhe monetare.
- Në muajin tetor, u vu re një ngadalësim i rritjeve mujore të agregatëve monetarë. Përjashtim bën agregati M3, rritja vjetore e të cilit mbeti e pandryshuar në nivelin e një muaji më parë, 16.1 për qind. Preferenca e individëve drejt investimeve në bono thesari, ka ndikuar në mosrritjen e depozitave me afat në lekë dhe, si rrjedhim, të M2.
- Për muajin tetor kredia për ekonominë ka vazhduar të ruajë nivele të larta rritjeje mujore. Gjatë muajit tetor teprica e kredisë u rrit me 4 miliardë lekë, duke arritur në 110 miliardë lekë ose 13.2 për qind e PBB-së.
- Tregu i parasë, në muajin nëntor është karakterizuar nga një nivel i qëndrueshëm likuiditeti. Nevojat afatshkurtra për likuiditet janë plotësuar në tregun ndërbankar, ndërsa likuiditeti i ofruar në tregun primar ka qenë mbi atë të kërkuar nga qeveria. Përmirësimi i situatës së likuiditetit në sistem është pasqyruar edhe në uljen e normave të interesit në këto dy tregje për periudhën tetor – nëntor.
- Të dhënat për muajin tetor në tregun e depozitave në lekë tregojnë rritje të normave të interesit. Tregu i kredive në lekë është karakterizuar nga luhatje të normave të interesit. Norma mesatare e ponderuar për kredinë në lekë në muajin tetor rezultoi 14.04 për qind, duke qenë 0.52 pikë përqindjeje më e lartë se në muajin shtator.
- Gjatë muajit nëntor, ndonëse me ritme më të ulta se një muaj më parë, leku ka vazhduar të mbiçmohet ndaj euros dhe të nënçmohet ndaj usd. Nivelet e tregtimit të lekut në fund të muajit nëntor janë 122.79 lekë/euro dhe 104.26 lekë/usd.

II. ECURIA E INFLACIONIT NË MUAJIN NËNTOR.

Inflacioni vjetor në muajin nëntor 2005 shënoi vlerën 3.0 për qind, ndërsa inflacioni mesatar vjetor rezultoi 2.4 për qind. Gjatë tre muajve të fundit, inflacioni vjetor është luhatur në mesin e objektivit prej 2 – 4 për qind të Bankës së Shqipërisë. Pavarësisht nga kriza energjitike dhe rritja e çmimit të naftës gjatë muajve të fundit, norma vjetore e inflacionit ka qëndruar brenda intervalit të synuar. Harmonizimi i politikave makroekonomike ka ndikuar pozitivisht në ecurinë e çmimeve të konsumit.

Gjithashtu, presionet inflacioniste të transmetuara nga ambienti i jashtëm tregtar kanë qenë të dobëta, duke favorizuar qëndrueshmërinë e çmimeve në vend. Megjithatë, rritja me bazë vjetore e disa kostove të rëndësishme për

konsumatorin, si çmimi i gazit dhe i naftës, qiraja e banesave dhe çmimet ushqimore, bënë që ndryshimi dymbëdhjetëmujor i çmimeve të konsumit, në fund të nëntorit, të ishte 0.8 pikë përqindjeje më i lartë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.


II.1 ECURIA E INFLACIONIT DHE E GRUPEVE PËRBËRËSE.

Struktura e kontributit individual të grupeve të shportës së mallrave të konsumit në inflacionin total, ka qenë relativisht e qëndrueshme gjatë dy viteve të fundit. Grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji”, “Transport” dhe “Hotele, kafene, restorante” kanë vazhduar të kontribuojnë në rritjen e normës vjetore të inflacionit edhe në muajin nëntor 2005.

Grupi “Ushqime dhe pije joalkolike” ka dhënë një kontribut minimal, prej 0.07 pikësh përqindjeje, në inflacionin e muajit nëntor. Kjo vlerë pozitive pasqyron një sjellje të ndryshme nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar, kur kontributi ishte në nivelin negativ -0.7 pikë përqindjeje.


Megjithatë, “Ushqime dhe pije joalkolike” ka ndikuar përgjithësisht në uljen e inflacionit gjatë dy viteve të fundit dhe ecuria e tij nuk ka qenë problematike as gjatë tremujorit të fundit. Rritja e çmimeve të mallrave ushqimorë gjatë muajve të fundit është ndikuar dhe nga rritja e çmimeve të tyre në vendet partnere, si Italia dhe Greqia.

Grafik 1. Inflacioni vjetor (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit të grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” (në vend dhe jashtë) si dhe kontributi i inflacionit të këtij grupi në inflacionin total.

	Inflacioni vjetor'04	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor'05	Kontributi (pp)	Itali ¹ Inflacioni vjetor'05	Greqi ² Inflacioni vjetor'05
Shtator	-2.9	-1.2	1.5	0.6	0.1	2.1
Tetor	-2.2	-0.9	1.7	0.7	0.2	2.7
Nëntor	-1.6	-0.7	0.2	0.07	-	2.6

Burimi: Banka e Shqipërisë, <http://www.statistics.gr> dhe <http://www.istat.it>.

Grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” dha një kontribut prej 2.3 pikësh përqindjeje në formimin e normës vjetore të inflacionit. Ndikimi i këtij grupi në inflacionin e këtij muaji reflektoi – krahas çmimit të lartë të energjisë elektrike - rritjen e çmimit të qirasë së banesave (me 1.2 për qind) dhe rritjen e çmimeve të lëndëve djegëse: gazit me 9.5 për qind dhe druve të zjarrit me 4.5 për qind.


Rritja e këtyre të fundit dëshmon për përdorimin më të madh të këtyre lëndëve djegëse në mungesë të energjisë elektrike.

Tabelë 2. Inflacioni dhe kontributi në inflacionin total i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” dhe nëngrupeve kryesore të tij.

	Kontributi brenda grupit (pp)			Kontributi në inflacionin total	Inflacioni vjetor '05
	Qira	Renta e imputuar	Lëndë djegëse, energji		
Shtator	0.05	0.56	1.37	2	7.7
Tetor	0.06	0.66	1.38	2.1	8.2
Nëntor	0.07	0.83	1.4	2.3	9

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Grupi “Transport” ndikoi në rritjen e normës vjetore të inflacionit me 0.21 pikë përqindjeje, gjatë muajit nëntor. Megjithëse në rënie ndaj muajve të mëparshëm, kontributin kryesor brenda këtij grupi vazhdon ta japë nëngrupi “Shërbime ndaj mjeteve personale”³, në të cilin bën pjesë dhe çmimi i naftës.




Grupet e tjera të shportës kanë dhënë një impakt të vogël në inflacionin total të muajit nëntor. Kështu, grupi “Hotele, kafene, restorante” kontribuoi me 0.2 pikë përqindjeje, grupi “Shërbimi arsimor” kontribuoi me 0.1 pikë përqindjeje dhe grupi “Shëndeti” kontribuoi me 0.16 pikë përqindjeje.

II.2 AMBIENTI MAKROEKONOMIK DHE ÇMIMET E KONSUMIT

Inflacioni vjetor dhe inflacioni mesatar në muajin nëntor 2005 qëndruan brenda objektivit prej 2 – 4 për qind. Kriza energjitike dhe çmimet e larta të naftës ndikuan në rritjen e normës së inflacionit. Gjithsesi, presionet inflacioniste të ardhura prej tyre, janë zbutur nga politika e kujdesshme fiskale dhe monetare.

Politika monetare

Në kushtet e niveleve të qëndrueshme të inflacionit në vend dhe parashikimeve të favorshme për të edhe gjatë periudhës së ardhme, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare neutrale. Rritja me ritme relativisht të shpejta e ofertës monetare është kompensuar nga rritja e kërkesës së ekonomisë për të. Nga ana tjetër, rënia e raportit të parasë jashtë bankave ndaj M3 dhe ulja e vazhdueshme e normave afatgjata të interesit, sugjerojnë se pritjet inflacioniste mbeten nën kontroll.



Politika fiskale

Duke respektuar kornizat e programit buxhetor, politika fiskale ka luajtur një rol pozitiv në ecurinë e çmimeve të konsumit në ekonomi. Të ardhurat janë vjelë në masën 97.3 për qind ndërsa shpenzimet janë realizuar në masën 95 për qind të planit, gjatë 10 muajve të parë të vitit.

Kujdesi në realizimin e shpenzimeve dhe në mbledhjen e të ardhurave ka krijuar kushte për mbajtjen e deficitit brenda kufirit të planifikuar, duke mos përcjellë impulse inflacioniste në ekonomi.


Kursi i këmbimit dhe inflacioni i importuar

Sjellja e kursit të këmbimit të lekut ndaj euros dhe dollarit ka qenë e ndryshme gjatë dy muajve të fundit, duke pasqyruar raportet e dollarit me euron në tregjet ndërkombëtare. Në muajin nëntor, leku është nënçmuar me 5.9 për qind ndaj dollarit dhe është mbiçmuar me 3.7 për qind ndaj euros.

Zbutja e efektit kompensues të mbiçmimit të lekut krijon kushte për ndikim më të madh të presioneve të jashtme inflacioniste.


Megjithatë, mbiçmimi relativ i lekut ndaj euros do të vazhdojë të shërbejë si amortizues i presioneve që vijnë nga marrëdhëniet tregtare me vendet e Eurozonës, dhe kryesisht me Italinë dhe Greqinë.

Grafik 5. Ndryshimi vjetor i ofertës së parasë M3 (grafiku majtas) dhe ndryshimi vjetor i parasë jashtë bankave ndaj M3 (grafiku djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Norma vjetore e inflacionit (boshti majtas) dhe rritja vjetore e shpenzimeve buxhetore (boshti djathtas).



Burimi: Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë.

Tabelë 3. Ndryshimet vjetore në inflacionin e vendeve partnere dhe në kursin e këmbimit (në përqindje).


	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor
Greqi ⁴	3.2	3.3	3.9	3.7	3.9	3.9	3.5
Itali ⁵	1.9	1.8	2.1	2.0	2.0	2.2	-
Lek/euro	-2.3	-1.0	-1.8	-2.4	-1.0	1.6	5.9
Lek/usd	-7.4	-1.2	0.0	-3.3	-1.4	-2.1	-3.7

Burimi: Banka e Shqipërisë, <http://www.statistics.gr> dhe <http://www.istat.it>.

Çmimet e naftës


Në rritjen e normës së inflacionit gjatë muajve të fundit ka ndikuar edhe rritja e çmimeve të naftës në vend. Kontributi mesatar i grupit "Transport" në inflacion ka qenë në nivelin 0.24 pikë përqindjeje gjatë tre muajve të fundit, duke shënuar rritje në krahasim me kontributin prej 0.18 pikësh përqindjeje të dhënë në vitin 2004 dhe me kontributin prej 0.10 pikësh përqindjeje dhënë në

Grafik 7. Ndryshimi vjetor i çmimeve të naftës në vend, në tregun ndërkombëtar dhe i kursit të këmbimit lek/usd.



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Bloomberg.

Grafik 8. Rritja vjetore e agregatit M2 real.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

vitin 2003. Mbiçmimi i lekut ndaj dollarit amerikan si dhe kriza energjitike në vend kanë ushtruar presion për rritjen e çmimit të këtij produkti në vend.

III. POLITIKA MONETARE DHE ZHVILLIMET MONETARE

III.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare neutrale gjatë muajit nëntor, duke mbajtur të pandryshuar nomën bazë të interesit⁶. Zhvillimet makroekonomike flasin për presione inflacioniste të qëndrueshme dhe nën kontroll. Norma e inflacionit në muajin nëntor rezultoi 3.0 për qind kundrejt inflacionit prej 3.3 për qind të muajit tetor. Gjithashtu, situata monetare paraqitet e stabilizuar, pas luhatjeve të treguesve monetarë të vëna re në muajin shtator.

Implementimi i politikës monetare gjatë muajve tetor-nëntor është realizuar nëpërmjet pranisë aktive të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor dhe administrimit të likuiditetit të sistemit.

Ndërhyrjet valutore kanë kontribuar në zbutjen e luhatshmërive të kursit të këmbimit. Këtë vit, pjesëmarrja në tregun valutor ka qenë e shtrirë në një periudhë kohore relativisht të gjatë krahasuar me vitin 2004. Ndërhyrjet valutore janë realizuar në mënyrë graduale që prej muajit gusht, duke iu përshtatur intensitetit të flukseve valutore dhe presioneve mbiçmuese që ato ushtrojnë në treg. Sasia e likuiditetit të injektuar në ekonomi nëpërmjet blerjeve valutore është rreth 6.3 miliardë lekë⁷.

Prania e Bankës së Shqipërisë në tregjet e parasë ka synuar administrimin e gjendjes së likuiditetit të sistemit bankar. Gjatë muajve tetor-nëntor sistemi bankar ka rezultuar mesatarisht me tepriçë likuiditeti prej afërsisht 4 miliardë lekë. Në kushtet e qëndrueshmërisë së normave të interesit në tregjet financiare, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e repove njëjavore me çmim fiks dhe shumë të pakufizuar për tërheqjen e likuiditetit të tepërt të bankave të nivelit të dytë.

Njëkohësisht, ndërhyrjet valutore kanë përmirësuar realizimin e objektivave sasiore të Bankës së Shqipërisë gjatë muajve tetor-nëntor⁸.

Tabelë 4. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

	Dhjetor '04	Mars '05	Qersh '05	Shtator '05	Tetor '05	Nëntor '05*
Rezervat Ndërkombëtare Neto (milionë dollarë)						
Objektivi	942	1,073	1,086.7	1,094.6	1,108.5	1,118.5
Aktuale	1,105	1,107	1,098.0	1,094.6	1,119.1	1,116.9
Diferenca	163	35	11.3	0.0	10.6	2.6
Mjetet e Brendshme Neto (miliardë lekë)						
Objektivi	79	61	60.0	65.7	65.7	65.7
Aktuale	61	53	63.6	65.7	57.8	55.8
Diferenca	-18	-8	3.6	0.0	-7.9	-9.8
Kredia e Brendshme Neto për Qeverinë (miliardë lekë)						
Objektivi	286	292	297.7	302.7	304.7	306.7
Aktuale	285	288	294.4	301.6	299.5	--
Diferenca	-1	-4	-3.2	-1.1	-5.2	--

Burimi: Banka e Shqipërisë


* Të dhëna operative.

III.2 ECURIA E AGREGATËVE MONETARË


Oferta monetare ka shënuar një rritje mujore të moderuar gjatë tetorit 2005, duke reflektuar rënien e kërkesës së qeverisë për para dhe efektin negativ të mbiçmimit mujor të lekut. Nga ana tjetër, rritja e kredisë për ekonominë në lekë dhe blerjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor kanë vazhduar të jenë dy burime të rëndësishme të gjenerimit të ofertës monetare në lekë, duke balancuar efektin negativ të kërkesës së qeverisë në rritjen e agregatit M2. Struktura kohore e ofertës monetare ka vazhduar zhvendosjen drejt mjeteve monetare më pak likuide, ndërsa struktura valutore e saj ka patur tendencë të stabilizuar.

Ecuria mujore e ofertës monetare, në muajin tetor, ka shfaqur ngadalësim krahasuar me muajin e kaluar, duke shënuar rritje prej 1.2 miliardë lekësh ose 0.2 për qind. Ritmi i rritjes vjetore të agregatit M3 në muajin tetor është stabilizuar në 16.1 për qind. Agregati monetar në lekë M2, ka shënuar një rritje të ulët mujore prej 0.6 miliardë lekësh (0.1 për qind), nga 3.2 miliardë lekë që ishte rritja e tij në muajin shtator. Ndonëse preferenca e individëve është orientuar më shumë drejt aseteve financiare në lekë, rritja e portofoleve në lekë të tyre ka marrë kryesisht formën e investimeve në bono thesari, duke mos u reflektuar në ritme të larta rritjeje për depozitat me afat në lekë (komponenti kryesor i M2). Rritja e depozitave në lekë me 2.2 miliardë lekë në muajin tetor, është mbështetur në rritjen e lartë të depozitave pa afat (4.0 miliardë lekë), ndërkohë që depozitat me afat në lekë kanë shënuar një rënie mujore prej 1.8 miliardë lekësh⁹. Nga ana tjetër, preferenca e individëve për të investuar në bono thesari është rritur nga diferenca e ndjeshme midis normave të interesit të këtyre dy aseteve financiare.


Grafik 9. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.




Grafik 10. Raporti i PjB ndaj M3 dhe norma mesatare e interesit real (shkalla djathtas).



Grafik 11. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3.



Grafik 12. Kontributi i përbërësve të kërkesës për mjete monetare në rritjen vjetore të M3.



Përbërësi tjetër i agregatit M2, paraqja jashtë bankave, ka dhënë një kontribut negativ në rritjen e ofertës monetare, duke shënuar një rënie mujore prej 1.6 miliardë lekësh ose 1.1 për qind. Norma e rritjes vjetore të parasë jashtë bankave ka pësuar rënie në 10.4 për qind, nga 12.1 për qind që ishte një muaj më parë. Vazhdimi i kthimit të parasë në sistem është shoqëruar me rënien e peshës së saj në ofertën monetare. Në muajin tetor, raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3, zbriti në 24.6 për qind, duke shënuar një rënie prej 0.4 pikësh përqindjeje në krahasim me muajin shtator.

Reduktimi sezonal i flukseve hyrëse valutore është reflektuar në ngadalësimin e rritjes së depozitave në valutë, në muajin tetor. Niveli i tyre ka shënuar një rritje mujore prej 0.7 miliardë lekësh, kundrejt rritjes me 3.3 miliardë lekë në muajin shtator. Rritja e depozitave në valutë është ndikuar negativisht nga mbiçmimi i lekut gjatë muajit tetor, në masën 0.6 miliardë lekë. Norma e rritjes vjetore të depozitave në valutë ka ardhur duke u stabilizuar, duke qëndruar në 32.7 për qind, nga 32.5 për qind që ishte në muajin shtator. Rritja e depozitave në valutë gjatë muajit tetor është mbështetur kryesisht në rritjen depozitave të sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 74 për qind të rritjes së depozitave totale në valutë. Ndërkohë, depozitat e individëve të cilat përbëjnë pjesën dërrmuese të depozitave në valutë, nuk kanë kontribuar në rritjen e tyre në muajin tetor.

Ngadalësimi i agregatit M2 në muajin tetor, është pasqyruar në rritjen e lehtë të peshës së depozitave valutore në ofertën monetare. Raporti i depozitave në valutë ndaj M3 është rritur lehtësisht në 27.2 për qind ose 0.1 pikë përqindjeje më i lartë se niveli i muajit shtator.

III.3 KËRKESA PËR MJETE MONETARE

Përbërësit e kërkesës për mjete monetare kanë njohur rritje të diferencuar në muajin tetor. Rritja e kredisë për ekonominë ka kontribuar me rreth 60 për qind në rritjen vjetore të ofertës monetare, ndërsa kërkesa e qeverisë ka dhënë kontributin më të vogël. Ecuria pozitive e kredisë për ekonominë po çon në rritjen e peshës të saj ndaj totalit të mjeteve monetare.

Kredia për ekonominë ka vazhduar të ruajë nivele të larta rritjeje mujore edhe gjatë muajit tetor. Gjatë këtij muaji, teprica e kredisë u rrit me 4 miliardë lekë, duke arritur në 110 miliardë lekë ose 13.2 për qind e PBB-së¹⁰. Në terma vjetorë, rritja e kredisë është 74.5 për qind, duke qëndruar në nivele të larta, të krahasueshme me një muaj më parë. Në muajin tetor u akorduan gjithsej 8.4 miliardë lekë ose 12 për qind më shumë se një vit më parë.


Kredia në lekë ka patur një nga performancat më të mira mujore gjatë vitit, duke shënuar një rritje mujore prej 1.8 miliardë lekësh. Si rezultat, në muajin tetor, është vënë re rritje e pjesës së portofolit të kredisë në lekë ndaj portofolit në total. Kredia për individët ka ruajtur të njëjtat rritje të larta mujore si dhe muajt e mëparshëm të vitit. Në fund të muajit tetor, portofoli i individëve është rreth 34 miliardë lekë ose 78 për qind më i lartë se një vit më parë. Orientimi i bankave drejt përmbushjes së kërkesave të individëve, ka ndikuar edhe në angazhimin e tyre drejt kreditimit në lekë.

Interesimi i bankave për kreditimin në lekë dhe për kreditimin e individëve vihet re edhe në rritjen e vazhdueshme të peshës së tyre ndaj totalit të kredisë. Përpjesat e kredisë së re në lekë dhe e kredisë për individët ndaj totalit janë rritur përkatësisht me rreth 0.4 pikë përqindje dhe 4 pikë përqindje brenda muajit.


Angazhimi i bankave drejt sektorit të bujqësisë ka vijuar të rritet edhe gjatë muajit tetor. Rritje të lehtë të portofolit të kredisë kanë shfaqur dhe sektori i ndërtimit dhe ai i pasurive të paluajtshme. Nga ana tjetër, kjo rritje është balancuar disi nga rënia në sektorin e tregtisë, që megjithatë vazhdon të jetë sektori më i kredituar i ekonomisë me rreth 19 për qind të portofolit të kredisë së gjithë sistemit bankar.

Në muajin tetor mjetet valutore neto të sistemit bankar kanë shënuar rritje me 13.8 milionë usd. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes të rezervave valutore neto të Bankës së Shqipërisë me 27.9 milionë usd ndërkohë që mjetet valutore neto të bankave të nivelit të dytë kanë pësuar ulje me 14.1 milionë usd. Rritja e rezervës valutore neto të Bankës së Shqipërisë ka ardhur si rezultat i ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun valutë. Bankat e nivelit të dytë kanë rritur detyrimet valutore me 11.7 milionë usd, kryesisht si rezultat i rritjes së kredisë nga jorezidentët. Gjatë muajit tetor, është vënë re akordim i kredisë në valutë në nivele më të larta se hyrja e depozitave në valutë në sistemin bankar.

Grafik 13. Rritja vjetore e kredisë sipas monedhës dhe në total.




Grafik 14. Niveli i mjeteve valutore neto të sistemit bankar.



Huamarrja e brendshme e deficitit buxhetor arriti në 17.1 miliardë lekë në muajin tetor, duke shënuar një rritje prej 2.3 miliardë lekësh gjatë këtij muaji. Megjithatë, rritja me 4.4 miliardë lekë e depozitës së qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë ka bërë që financimi neto të ulet me 2.2 miliardë lekë gjatë muajit tetor. Qeveria ka plotësuar kërkesën e saj për para me anë të shitjeve të obligacioneve qeveritare dy dhe tre-vjeçare. Emetimi i tyre gjatë muajit tetor ishte përkatësisht 1.4 miliardë lekë dhe 2.0 miliardë lekë. Ndërkohë, është rritur me 0.9 miliardë lekë dhe niveli i bonove të thesarit të blera në tregun primar. Nga ana tjetër, qeveria ka shlyer detyrimin për kredinë direkte marrë një muaj më parë prej 2.0 miliardë lekësh.

Grafik 15. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).




Individët kanë rritur portofolet e tyre të bonove të thesarit për muajin tetor me rreth 1.8 miliardë lekë, ndërsa bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e kanë ulur atë përkatësisht me 0.1 miliardë lekë dhe 0.6 miliardë lekë. Portofoli i bonove të thesarit në total është rritur me rreth 1.1 miliardë lekë.

III.4 TREGJET, NORMAT E INTERESIT DHE KURSI I KËMBIMIT

Tregu i parasë është karakterizuar nga një nivel i qëndrueshëm i likuiditetit në muajin nëntor. Nevojat afatshkurtra për likuiditet janë plotësuar në tregun ndërbankar, ndërsa likuiditeti i ofruar në tregun primar ka qenë mbi atë të kërkuar nga qeveria. Përmirësimi i situatës së likuiditetit në sistem ka ndikuar shpejt në uljen e normave të interesit në këto dy tregje, në periudhën tetor-nëntor. Të dhënat për muajin tetor në tregun e depozitave në lekë tregojnë rritje të normave të interesit, duke sjellë uljen e diferencës me *yield*-et e bonove të thesarit. Interesi real për depozitat në lekë në muajin tetor është ulur si pasojë e rritjes së inflacionit vjetor në këtë muaj.

Grafik 16. Tendanca e normave të interesit në tregje (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

III.4.1 ECURIA E LIKUIDITETIT

Niveli mesatar ditor i likuiditetit në muajin nëntor rezultoi në vlerën 3.8 miliardë lekë ose 0.1 miliardë lekë më shumë se në muajin tetor. Një pjesë e tij është investuar në ankandet njëjavore të marrëveshjeve të riblerjes me çmim fiks, mesatarisht në vlerën 2.0 miliardë lekë.

Në tregun ndërbankar, aktiviteti huadhënës ka qëndruar pothuajse në të njëjtat ritme si një muaj më parë. Vëllimi mesatar i transaksioneve njëditore në

tregun ndërbankar shënoi vlerën 0.5 miliardë lekë, nga 0.6 miliardë lekë në muajin tetor, ndërsa ai i transaksioneve njëjavore shënoi vlerën 1.5 miliardë lekë ose 0.2 miliardë lekë më shumë se në muajin tetor.

Likuiditeti i ofruar në ankandet e bonove të thesarit dhe të obligacioneve dyvjeçare ka qenë i mjaftueshëm për financimin e deficitit buxhetor, duke mos sjellë nevojën për kredi direkte në muajin nëntor.



III.4.2 ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

Gjatë muajit tetor 2005, tregu i parasë dhe i depozitave në lekë ka shfaqur tendenca në kahe të kundërta të normave të interesit. Të dhënat e muajit tetor tregojnë se normat e depozitave në lekë, në përgjithësi janë rritur. Ndërsa në tregun e parasë, të dhënat për periudhën tetor-nëntor tregojnë ulje të normave të interesit, si rezultat i përmirësimit të gjendjes së likuiditetit në treg. Kjo shihet në uljen e interesave të transaksioneve njëditore në tregun ndërbankar dhe në uljen e *yield*-it të bonove të thesarit për të gjitha afatet. Ulja e *yield*-it të bonove të thesarit dhe e obligacioneve dyvjeçare, ka sjellë uljen e kostos së borxhit të brendshëm të qeverisë.

Tendencat në kahe të kundërta të normave të interesit të bonove të thesarit dhe të depozitave në lekë, kanë ndikuar në ngushtimin e *spread*-it të interesave midis tyre. Ky *spread*, i cili në muajin shtator kishte arritur nivelet më të larta të viteve të fundit, në muajin tetor ra në nivelin 1.8 për qind, 3.2 për qind dhe 2.7 për qind, përkatësisht për afatet 3, 6 dhe 12-mujore.

Gjatë muajit tetor, interesat realë të depozitave me afat 12-mujor në lekë janë ulur, duke arritur në nivelin 1.96 për qind nga 2.11 për qind një muaj më parë dhe 4.02 për qind një vit më parë. Këtu ka ndikuar kryesisht rritja e inflacionit në krahasim me një muaj dhe me një vit më parë.

Tregu i kredive në lekë vazhdon të karakterizohet nga luhajtje të normave të interesit, ku banka të ndryshme shfaqin prirje të ndryshme mbi kahun e lëvizjes së interesave, në varësi të natyrës së kredive të lëvruara në muajin përkatës. Norma mesatare e ponderuar për kredinë në lekë në muajin tetor, rezultoi 14.04 për qind, duke qenë 0.52 pikë përqindjeje më e lartë se në muajin shtator dhe 0.67 pikë përqindjeje më e lartë se një vit më parë.



Prirja e përgjithshme e interesave të depozitave në valutë (euro,usd), në muajin tetor, ka qenë rritja e tyre në të gjitha afatet, me përjashtim të depozitave me afat 1 dhe 3-mujor në euro. Në rritjen e interesave të depozitave në valutë kanë ndikuar politika e shtrënguar monetare e zbatuar nga Fed-i, pritshmëritë për shtrëngim të politikës monetare nga BQE dhe Fed-i, rritja e konkurrencës në sistemin bankar etj.. Rritje të interesave të depozitave në valutë ka patur dhe në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Tregu i kredive në valutë, sikurse dhe tregu i depozitave në valutë, është karakterizuar nga rritja normave të interesit, gjatë muajit tetor. Në rritjen e këtyre interesave ka ndikuar rritja e kostos së pranimit të depozitave në valutë, krahas faktorëve të kërkesës për kredi, të ndryshimit të strukturës së kredihënies etj.. Në muajin tetor 2005, interesi mesatar i ponderuar i kredive në usd, arriti në 9.8 për qind nga 8.9 për qind që ishte një muaj më parë dhe nga 8.11 për qind që ishte një vit më parë. Ndërkohë, interesi mesatar i ponderuar i kredive në euro arriti në 7.1 për qind, nga 5.8 për qind që ishte një muaj më parë dhe 8.6 për qind, një vit më parë.

III.4.3 KURSI I KËMBIMIT

Në tregun valutor është vërejtur pothuajse e njëjta ecuri e valutave duke përforcuar ecurinë e muajve më parë. Leku ka vazhduar të mbiçmohet ndaj euros dhe të nënçmohet ndaj usd gjatë muajit nëntor, ndonëse në ritme më të ulëta. Kështu, në fund të muajit nëntor leku është mbiçmuar me 0.2 për qind kundrejt euros dhe është nënçmuar me 2.2 për qind kundrejt usd. Nivelet e tregtimit të lekut në fund të muajit nëntor janë 122.79 lekë/euro dhe 104.26 lekë/usd. Në terma efektivë nominalë¹¹ leku është mbiçmuar me 1.7 për qind gjatë muajit nëntor.

Edhe gjatë muajit nëntor, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor duke blerë valutë. Ndërhyrja valutore e Bankës së Shqipërisë gjatë kësaj periudhe ka kontribuar në mbajtjen e kursit të këmbimit të lekut në nivele të qëndrueshme duke zbutur luhatshmërinë e tij.

Grafik 19. Ecuria e kursit efektiv nominal të këmbimit të lekut (NEER).



SHËNIME

¹ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>.

² Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar të Greqisë; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>.

³ Inflacioni vjetor i këtij nëngrupi për muajin tetor është 10 për qind.

⁴ Burimi: Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimit Statistikor Kombëtar të Greqisë; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>.

⁵ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>.

⁶ Ndryshimi i fundit i normës bazë të interesit, ulja e saj me 0.25 pikë përqindjeje, ka ndodhur në muajin mars 2005.

⁷ Deri në muajin nëntor 2005.

⁸ Objektivat sasiorë të Bankës së Shqipërisë janë rishikuar në kuadër të negociimit të marrëveshjes së re me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Objektivat sasiorë të tremujorit të fundit të vitit 2005 nuk kanë natyrë kushtëzuese.

⁹ Rënia e depozitave me afat në lekë është shkaktuar nga riklasifikimi i depozitave të individëve nga banka "Raiffeisen", nga depozita me afat në depozita pa afat.

¹⁰ Përmirësimi i treguesit të kredisë ndaj PBB-së ka ardhur pjesërisht si rezultat i ecurisë pozitive të kredisë për muajin tetor dhe pjesërisht si pasojë e rishikimit në rënie të vlerës së parashikuar të PBB-së për fundin e vitit 2005.

¹¹ Kursi i lekut i matur kundrejt shportës së valutave euro dhe dollar me peshat përkatëse që zë secila monedhë në tregtinë e jashtme.

SHTOJCË STATISTIKORE

INFLACIONI.

Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje).

	2001	2002	2003	2004	2005
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.6
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	1.8
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	2.3
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	3.1
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	3.3
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	3.0
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	
Mesatar	3.1	5.2	2.2	3.0	2.4

Burimi: INSTAT.

Tabelë 2. Kontributi në inflacionin total i grupeve përbërëse të shportës.

	dhjetor-03	dhjetor-04	mars-05	qershor-05	shtator-05	tetor-05	nëntor-05
Ushqime dhe pije jo alkolike	1.20	0.12	-0.74	0.65	0.61	0.71	0.09
Qira, ujë, lëndë djegëse, energji.	0.95	2.08	2.40	1.83	2.00	2.13	2.30
Transport	0.14	0.16	0.11	0.14	0.29	0.23	0.22
Hotele, kafe dhe restorant.	0.18	0.25	0.14	0.12	0.12	0.17	0.21
Të tjera	0.84	-0.42	-0.27	0.15	0.11	0.07	0.13
Totali	3.31	2.19	1.64	2.89	3.14	3.32	2.94

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

AGREGATËT MONETARË.

Tabelë 3. Ecuria e treguesve monetarë në muajin tetor (në miliardë lekë).

	Tetor	Ndryshimi mujor		Ndryshimi vjetor	
	2005	Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Para jashtë bankave	139.9	-1.6	-1.1	13.2	10.4
Depozita totale	427.6	2.9	0.7	65.3	18.0
- në lekë	273.5	2.2	0.8	27.4	11.1
- në valutë	154.1	0.7	0.4	38.0	32.7
Depozita pa afat	128.8	4.3	3.5	58.9	84.2
- në lekë	74.9	4.0	5.6	49.2	191.0
- në valutë	53.9	0.3	0.6	9.7	21.9
Depozita me afat	298.8	-1.5	-0.5	6.5	2.2
- në lekë	198.5	-1.8	-0.9	-21.8	-9.9
- në valutë	100.2	0.3	0.3	28.3	39.3
M1	214.8	2.4	1.1	62.4	41.0
M2	413.3	0.6	0.1	40.6	10.9
M3	567.4	1.2	0.2	78.6	16.1
Baza monetare	188.0	-6.1	-3.1	21.0	12.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Ecuria e disa treguesve kryesorë.

	2003	2004	T1-'05	T2-'05	T3-'05	Tetor '05
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	448.4	507.2	521.6	541.8	566.2	567.4
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	71.5	68.9	68.7	69.9	69.1	69.0
- Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	60.2	55.1	53.4	52.2	50.3	49.6
- Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	11.3	13.8	15.3	17.7	18.7	19.4
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	13.7	16.9	17.9	20.8	22.2	22.9
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	6.8	9.0	9.3	11.2	12.4	13.2
Raporti kredi / depozita (në %)	15.7	19.0	20.3	23.6	25.0	25.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Ecuria e treguesve monetarë në muajin tetor (në milionë lekë).

	Në vlerë absolute	Pesha në M3 (në %)	Kontributi vjetor (në %)	Ndryshimi mujor	Ndryshimi vjetor
Mjete valutore neto	212,656	37.5	27.8	168.49	21,824.40
Pretendime neto ndaj qeverisë	281,682	49.6	17.5	(3,231)	13,730
Kredi për ekonominë	110,039	19.4	59.8	4,005.6	46,983.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Ecuria e treguesve të MVN sipas grupeve kryesore.

	Ne vlerë absolute	Ndryshimi mujor	Ndryshimi vjetor
Mjete valutore neto	2,080.7	13.8	163.0
Mjete valutore	2,310.8	25.6	100.5
Banka e Shqipërisë	1,374.3	28.0	100.5
BPD	936.4	(2.4)	
Detyrimet valutore	230.1	11.8	(2.2)
Banka e Shqipërisë	108.6	0.1	(2.2)
BPD	121.5	11.7	

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 7. Ecuria e treguesve të NCG sipas grupeve kryesore.

	Në vlerë absolute	Ndryshimi mujor	Ndryshimi vjetor
Pretendime ndaj qeverisë neto	281,682	(3,230.6)	13,729.7
Banka e Shqipërisë	57,031.0	(6,288.7)	5,904.8
BPD	224,651.0	3,058.1	7,824.8
Depozita pranë Bankës së Shqipërisë	12,149.2	4,288.7	(2,586.6)
Deficiti buxhetor	(11,270.4)	2,190.4	3,994.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8. Tregues të tepricës së kredisë në përqindje ndaj totalit.

	2003	2004	T-1 '05	T-2 '05	T-3 '05	Tetor '05
Teprica e kredisë (në mld lekë)	50.7	69.3	79.0	95.9	106.0	110.0
Kredi afatshkurtër	46.0	34.0	34.1	33.7	31.6	31.8
Kredi afatmesme	33.3	36.0	34.5	33.1	31.2	31.3
Kredi afatgjatë	20.7	30.0	31.4	33.1	36.9	36.9
Kredi për individët	24.5	30.6	31.0	30.8	31.4	31.7
Kredi për sektorin privat	75.5	69.4	69.0	69.2	68.6	68.3
Lekë	19.6	19.5	20.1	22.9	23.7	24.5
Valutë	80.4	80.5	79.9	77.1	76.3	75.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 9. Ecuria e kredisë për degët më kryesore të ekonomisë.

	2002	2003	2004	T1 '05	T2 '05	T3 '05	Tetor '05
Bujqësia, Gjuetia dhe Silvikultura	0.8	1	1.5	1.5	1.5	2.4	2.51
Industria përpunuese	17	17	17.1	16.7	15.6	13.9	13.8
Ndërtimi	8.6	10	9.8	11.2	11.2	12.8	12.9
Tregtia, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiakë	0.4	34	23.3	20.6	19.1	20.0	18.9
Hotele dhe Restorante	6	6	8.3	5.2	4.7	4.4	4.4
Pasuritë e patundshme	9.1	13	9.8	14.7	13.5	13.9	14.0
Të tjera	18.1	19	30.2	30.1	34.3	32.6	33.5
Totali	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 10. Tregues të kredisë së re në përqindje ndaj totalit.

	2004		2005			
	Shtator	Totali	T1	T2	T3	Tetor
Kredia e re (në mld lekë)	5.7	99.7	22.1	32.8	32.1	8.5
Kredi afatshkurtër	58.78	62.54	53.2	47	47.4	44.5
Kredi afatmesme	22.56	22.53	22.4	31	30.3	30.0
Kredi afatgjatë	18.66	14.93	24.4	22	22.2	25.5
Lekë	38.79	32.59	30.1	32.8	30.2	33
Valutë	61.21	67.41	70	67.2	69.8	67

Burimi: Banka e Shqipërisë.

TREGJET FINANCIARE

Tabelë 11. Normat e interesit në fund të muajit nëntor dhe ndryshimi i tyre me periudhat e mëparshme (në pikë përqindje).

	Normat e interesit nëntor 2005	Ndryshimi nëntor-tetor 2005	Ndryshimi nëntor 2005 –nëntor 2004
Norma bazë e interesit	5.00%	0.00	-0.25
Tregu ndërbankar			
Interesi i tregut ndërbankar 1-ditor	4.1%	-0.98	+0.1
Interesi i tregut ndërbankar 7-ditor	6.2%	+0.2	+0.3
Tregu primar			
yield-i i bono thesari 3 - mujore	5.4%	-0.5	-0.9
yield-i i bono thesari 6 - mujore	7.0%	-0.9	-0.3
yield-i i bono thesari 12 - mujore	7.3%	-0.7	-0.8
Tregu i obligacioneve			
yield-i i obligacioneve 2 - vjeçare	8.3%	-0.6	-0.95

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Tabelë 12. Normat e interesit dhe ndryshimi i tyre në tregun e depozitave dhe të kredive në lekë (në pikë përqindjeje).

	Normat e interesit tetor 2005	Ndryshimi tetor-shtator 2005	Ndryshimi tetor'05 –tetor '04
Norma bazë e interesit	5.00%	0.00	-0.50
Interesat e depozitave në lekë			
3 - mujore	4.11%	0.24	-0.65
6 - mujore	4.74%	0.19	-0.89
12 - mujore	5.32%	0.04	-0.81
Interesat e kredive në lekë			
Kredi deri 6 muaj	13.38%	0.84	2.41
Kredi 6 muaj - 1 vit	12.62%	-0.29	-1.81
Kredi 1-3 vjet	17.61%	1.31	-1.63
Kredi mbi 3 vjet	12.15%	-0.04	0.46

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Tabela 13. Normat e interesit të depozitave në valutë (në pikë përqindjeje).

	Normat e interesit tetor 2005	Ndryshimi tetor-shtator '05	Ndryshimi shtator'05 -shtator '04
Fed-norma bazë e interesit	3.75%	+0.00	+2.00
Interesat e depozitave në usd			
1 - mujore	1.97%	+0.02%	+0.93%
3 - mujore	2.35%	+0.03%	+1.01%
6 - mujore	2.63%	+0.08%	+1.02%
12 - mujore	3.08%	+0.06%	+1.07%
24 - mujore	3.83%	+0.65%	+1.33%
BQE-norma bazë e interesit	2%	0.00	0.00
Interesat e depozitave në euro			
1 - mujore	1.70%	-0.04%	+0.13%
3 - mujore	1.69%	-0.10%	+0.04%
6 - mujore	2.00%	+0.09%	+0.29%
12 - mujore	2.23%	+0.14%	+0.43%
24 - mujore	3.66%	+0.13%	+1.76%

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.99, datë 28.12.2005

PËR

MIRATIMIN E "DOKUMENTIT TË POLITIKËS MONETARE PËR VITIN 2006"

Në mbështetje të nenit 43, shkronjat "a" dhe "ç" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Dokumentin e Politikës Monetare për vitin 2006", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare me dërgimin e këtij dokumenti në: Kuvendin e Shqipërisë, Presidencë, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

BANKA E SHQIPËRISË

DOKUMENTI I POLITIKËS MONETARE PËR VITIN 2006.

Eksperienca botërore dhe ajo shqiptare kanë treguar në mënyrë të qartë se stabiliteti makroekonomik është një parakusht i domosdoshëm për sigurimin e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë. Ky stabilitet nënkupton zhvillimin e ekuilibruar të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, zbutjen e cikleve të biznesit dhe një luhatshmëri sa më të vogël të treguesve të rritjes ekonomike, të punësimit, të inflacionit dhe të normave të interesit. Krijimi i kushteve të tilla shoqërohet me uljen e rrezikut në ekonomi dhe me shpërndarjen më eficiente të faktorëve të prodhimit. Teoria ekonomike njeh dy instrumente, të cilat mund të përdoren për kontrollin e stabilitetit makroekonomik: politikën monetare dhe politikën fiskale.

Hartimi, miratimi dhe zbatimi i politikës monetare është e drejtë ekskluzive e Bankës së Shqipërisë, si autoriteti monetar i Republikës së Shqipërisë. Politika monetare ideohet dhe zbatohet në drejtim të përmbushjes së objektivit kryesor: arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Ajo synon administrimin e kushteve monetare të ekonomisë – ofertës monetare, normave të interesit dhe kursit të këmbimit – në funksion të realizimit të këtij objekti në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Politika monetare realizohet nëpërmjet ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregjet financiare. Në tërësinë e saj, ajo përfshin: pjesën teorike që përdoret për modelimin e saj; kuadrin e objektivave; si dhe instrumentet e përdorura për zbatimin e saj.

Dokumenti i Politikës Monetare për vitin 2006 është hartuar në vazhdim të “Planit të Zhvillimit Afatmesëm të Bankës së Shqipërisë (2003-2005)” dhe të Dokumenteve të Politikës Monetare për vitet 2004-2005. Strategjia bazë e politikës monetare për vitin 2006 dhe kuadri operacional i saj do të ruajnë parimet dhe trajtat kryesore të ndjekura gjatë vitit 2005. Megjithatë, Banka e Shqipërisë do të aplikojë modifikime graduale në to, duke synuar rritjen e eficiencës dhe aplikimin e standardeve më të përparuara. Këto ndryshime diktohen nga eksperienca vendase dhe e huaj në fushën e administrimit monetar si dhe nga ndryshimet strukturore të ekonomisë shqiptare.

Në këtë dokument, Banka e Shqipërisë detajon të gjitha elementet konkrete të politikës monetare për vitin 2006, veçanërisht në fushën e objektivave të politikës monetare dhe të kuadrit operacional të saj. Ky dokument shërben si bazë për orientimin e koordinimit të politikës monetare me politikat e tjera ekonomike të qeverisë. Publikimi i këtij dokumenti, zbërthen në terma konkretë angazhimin e Bankës së Shqipërisë për të qenë një institucion transparent.

* * *

BAZA LIGJORE

Në bazë të nenit 161 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë “... ka të drejtën ekskluzive të zbatimit të pavarur të politikës monetare”.

Në bazë të nenit 3, pika 4a¹, e ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", ky institucion ka si detyrë kryesore "të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë në mënyrë të pavarur politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor".

Në bazë të nenit 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", si objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë përcaktohet: "arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve".

Në bazë të nenit 43, pika a, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka këto kompetenca: "Të miratojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar kufijtë e operacioneve të Bankës së Shqipërisë në treg të hapur, përqindjen e interesave për depozitat në Bankën e Shqipërisë dhe për skontimet dhe huatë ose kreditë e Bankës së Shqipërisë, si dhe të rezervave dhe nivelit të rezervave të detyruara, që bankat e nivelit të dytë duhet të mbajnë në Bankën e Shqipërisë".

* * *

ROLI I POLITIKËS MONETARE

Politika monetare synon të ndikojë variablat ekonomike me anë të ndryshimit të normave afatshkurtra të interesit. Banka qendrore është në gjendje të ndikojë normat afatshkurtra të interesit në sajë të monopolit që i është njohur asaj për krijimin e parasë fizike dhe rezervave të bankave të nivelit të dytë. Në periudhën afatshkurtër, një ndryshim i ofertës monetare apo i normave të interesit në tregun e parasë ka një ndikim në aktivitetin ekonomik: prodhimin, punëzënien dhe nivelin e çmimeve. Ndërkohë, në afatin e gjatë, domethënë pasi në ekonomi të jenë verifikuar të gjitha përshtatjet e mundshme në sjelljen e agjentëve ekonomikë, ndryshimi i sasisë së parasë do të reflektohet vetëm në ndryshimin e nivelit të çmimeve, pa prekur variablat realë të ekonomisë. Ky konkluzion tashmë gëzon një mbështetje të gjerë nga mendimi teorik dhe zbatimi i tij në praktikë, përfshirë dhe eksperiencën e vendit tonë.

Nga ana tjetër, luhatjet e nivelit të çmimeve, situatat inflacioniste apo deflacioniste, janë të dëmshme për ekonominë. Kontributi më i qenësishëm që mund të japë banka qendrore në ekonomi është ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Ky është parimi kryesor i cili udhëheq politikën monetare të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë gjykon se ky parim ndahet edhe nga shtresa të gjera të publikut shqiptar.

BASHKËRENDIMI ME POLITIKAT E TJERA MAKROEKONOMIKE

Banka e Shqipërisë bashkërendon politikën e saj monetare me nevojat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe me strategjitë e hartuara për të. Në veçanti, një vëmendje e posaçme i kushtohet bashkërendimit me politikën fiskale, si një përcaktuese tjetër e rëndësishme e zhvillimeve ekonomike në vend.

Në të njëjtën kohë dhe pa cënuar parimin e bashkërendimit të politikave ekonomike të vendit, miratimi i politikës monetare nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe zbatimi i saj me anë të instrumenteve monetare, përcaktohen në mënyrë të pavarur nga Banka e Shqipërisë. Vendimet e politikës monetare do të jenë në përputhje me objektivin e mandatuar nga ligji, arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

OBJEKTIVI I INFLACIONIT PËR VITIN 2006

Çdo vit, Banka e Shqipërisë shpjegon publikisht mandatin e saj, duke dëshmuar kështu përgjegjshmëri institucionale, në përputhje me domosdoshmërinë për një qëndrim transparent për çështjet e politikës monetare. Shpjegimi i mandatit nënkupton përcaktimin në terma sasiorë të stabilitetit të çmimeve. Paralelisht me të, Banka e Shqipërisë informon edhe në lidhje me rrugët dhe instrumentet që ajo do të përdorë për arritjen e tij. Ky proces i shërben orientimit të pritjeve të publikut drejt objektivit të synuar të inflacionit.

Të arrish stabilitetin e çmimeve do të thotë të arrish norma të ulëta pozitive të inflacionit ose të ndryshimit të çmimeve të konsumit. Të ruash stabilitetin e çmimeve do të thotë të sigurosh norma të ulëta pozitive inflacioni për periudha relativisht të gjata kohe.

Për të konkretizuar këtë angazhim, Banka e Shqipërisë do të konsiderojë si objektiv të saj mbajtjen e inflacionit në nivelin 3 për qind me një mundësi luhatjeje ± 1 pikë përqindjeje rreth kësaj vlere qendrore. Si objektiv i inflacionit do të vazhdojë të konsiderohet rritja vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit, matur dhe publikuar nga INSTAT.

Vlera e sasiore e shpallur më sipër e objektivit të inflacionit, reflekton realitetin e ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim. Ekonomitë e tilla karakterizohen nga luhatje më të mëdha të çmimeve relative drejt gjetjes së ekuilibrave të duhur të ekonomisë së tregut. Synimi për nivele më të ulëta të inflacionit mund të impononte kosto të larta për ekonominë e vendit. Nga ana tjetër, ruajtja e objektivit të inflacionit në të njëjtin nivel me 6 vitet paraardhëse do të kontribuojë pozitivisht në konsolidimin e pritjeve inflacioniste rreth objektivit të shpallur të Bankës së Shqipërisë.

NIVELI I OBJEKTIVIT.

Ruajtja e inflacionit në nivele të ulëta do të ketë një kontribut pozitiv në zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Së pari, duke qenë një normë pozitive inflacioni ajo mban parasysht evolucionin teknologjik të produkteve dhe përmirësimin cilësor të tyre. Gjithashtu, shumë studime kanë treguar se ecuria e inflacionit ka një prirje të brendshme statistikore për të regjistruar vlera pozitive. Në realitet, një nivel inflacioni afër 0 mund t'i korrespondojë një situatë deflacioniste. Së dyti, norma e ulët e inflacionit ndihmon në ruajtjen e normave pozitive të interesit real. Normat reale pozitive të interesit ndihmojnë në thithjen e kursimeve të qytetarëve në sistemin bankar, duke ndikuar në stabilitetin e këtij të fundit dhe në ruajtjen e aftësisë së tij për të plotësuar nevojat e ekonomisë

dhe të qeverisë për mjete monetare. Së treti, një normë e tillë inflacioni i përshtatet nevojave të zhvillimit të ekonomisë shqiptare, si një ekonomi në tranzicion. Ajo lehtëson lëvizjen e çmimeve relative, duke kontribuar pozitivisht në rolin informues që përmban ky mekanizëm në shpërndarjen e fondeve në ekonomi. Shumica e vendeve të zhvilluara e përkufizojnë stabilitetin e çmimeve si një nivel inflacioni rreth 2 për qind. Duke qenë se Shqipëria është një vend në tranzicion, një nivel më i lartë inflacioni reflekton një rrezik më të lartë strukturor të pranishëm në ekonominë shqiptare si dhe një lëvizje më të madhe të çmimeve relative në të. Së katërti, duke qenë në të njëjtin nivel me objektivin e inflacionit gjatë katër viteve të fundit, ai do të ndikojë pozitivisht në stabilizimin e pritjeve inflacioniste në ekonomi dhe në rritjen e sigurisë në marrjen e vendimeve ekonomike. Nga ana tjetër, një nivel i tillë inflacioni dhe politika monetare e hartuar për përmbushjen e tij ndikojnë pozitivisht në ritmet e rritjes ekonomike, ashtu siç është provuar gjatë viteve të fundit.

Gjithashtu, objektivi i inflacionit në nivelin 3 për qind është konsistent edhe me dëshirën e vendit për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian në një periudhë sa më të shpejtë. Synimi për të kontrolluar rritjen e çmimeve në një nivel të përafërt, por më të lartë se objektivi i Bankës Qendrore Evropiane², i mundëson ekonomisë shqiptare një konvergjencë reale duke i lejuar në të njëjtën kohë hapësirën e nevojshme për të kryer ndryshimet e duhura strukturore.

FORMA E OBJEKTIVIT.

Objektivi i inflacionit për vitin 2006 do të jetë në formën e një vlere të vetme 3 për qind. Meqënëse, inflacioni është shpesh subjekt i veprimit të faktorëve të ofertës ose të rritjeve të administruara të çmimeve, luhatja e çmimeve të konsumit mund të mos jetë gjithnjë rrjedhojë e ndikimit të politikës monetare. Edhe pse politika monetare është e vëmendshme edhe ndaj këtyre faktorëve, ata nuk janë subjekt i ndërhyrjeve të dëshirueshme të politikës monetare. Për këtë arsye, përcaktohet edhe një interval luhatshmërie prej ± 1 pikë përqindjeje rreth vlerës qendrore, duke ndikuar pozitivisht në qëndrueshmërinë afatmesme të politikës monetare.

MATJE TË TJERA TË INFLACIONIT.

Banka e Shqipërisë, në funksion të rritjes së cilësisë së vendimmarrjes do të përdorë dhe matje të tjera të inflacionit. Këto matje krijojnë një bazë më të plotë për të marrë vendime sa më realiste. Kategoritë e tjera të inflacionit janë:

- Inflacioni bazë. Banka e Shqipërisë do të punojë në vazhdimësi gjatë vitit 2006 për të ndërtuar serinë e inflacionit bazë dhe për të perfeksionuar metodologjinë e llogaritjes së tij. Inflacioni bazë do të jetë një input i rëndësishëm në marrjen e vendimeve të politikës monetare.
- Inflacioni vjetor në nivel mesatar. Kjo kategori përfaqëson nivelin mesatar të inflacionit vjetor për dymbëdhjetë muajt e fundit, duke dhënë një informacion të vlefshëm në lidhje me prirjet e zhvillimeve në çmimet e konsumit. Si i tillë, inflacioni vjetor në nivel mesatar do të jetë një orientues

i rëndësishëm në procesin e marrjes së vendimeve të politikës monetare.

Gjithashtu, në përputhje me angazhimin e saj për adoptimin në të ardhmen e afërt të regjimit të inflacionit të shënjestruar, Banka e Shqipërisë do të punojë për rritjen e aftësive të saj analitike; për zgjerimin gamës së informacionit të përdorur për vendimmarrje; për rritjen e efektivitetit të kanaleve të transmisionit; dhe për rritjen sasiore dhe cilësore të komunikimit të saj me publikun.

Më konkretisht, gjatë vitit 2006 Banka e Shqipërisë do t'i kushtojë një rëndësi më të madhe ndërtimit të serive kohore dhe shfrytëzimit të informacionit të marrë nga treguesit e mëposhtëm:

- Indeksi i besimit të biznesit.
- Indeksi i besimit të konsumatorëve.
- Indeksi i tregut të pasurive të paluajtshme.

OBJEKTIVAT E NDËRMJETËM DHE OBJEKTIVAT OPERACIONALË

Kontrulli i inflacionit bazohet në kontrollin e treguesve të tjerë, të cilët, nga njëra anë, kanë lidhje të fortë me objektivin e inflacionit dhe, nga ana tjetër, janë nën një kontroll më direkt të Bankës së Shqipërisë. Këta janë objektivat e ndërmjetëm dhe operacionalë (sasiore). Objektivat e ndërmjetëm janë orientues (tregues), ndërsa objektivat operacionalë ndiqen me rigorozitet. Këta objektiva, së bashku me objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë, formojnë kuadrin e objektivave të saj.

Objektivi i ndërmjetëm për vitin 2006 është rritja vjetore e ofertës së parasë (M3). Përcaktimi i rritjes vjetore të M3 si objektiv i ndërmjetëm mbështetet në argumentin se inflacioni, duke qenë në përgjithësi fenomen monetar, ndikohet nga rritja në ofertën e parasë. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë synon të kontrollojë rritjen e mjeteve monetare në ekonomi, në mënyrë që oferta e mjeteve monetare të korrespondojë me nevojën e ekonomisë për mjete monetare reale. Duke u nisur nga parashikimi i rritjes ekonomike për vitin 2006, nga objektivi i Bankës së Shqipërisë për nivelin e inflacionit, si dhe nga trendet e zhvillimeve monetare, Banka e Shqipërisë do të synojë të kontrollojë rritjen e ofertës monetare në nivelin 11.8 për qind për vitin 2006.

Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ruajë një regjim të lirë të kursit të këmbimit. Vlera e lekut kundrejt valutave të huaja do të përcaktohet lirisht në tregun e këmbimit, në përgjigje të ligjeve të kërkesës dhe ofertës. Banka e Shqipërisë do të jetë e pranishme me ndërhyrje të veçanta në tregun valutor, duke synuar zbutjen e lëvizjeve afatshkurtra të kursit të këmbimit të lekut, të cilat janë në kundërshtim me prirjet afatgjata dhe me respektimin e objektivit të rezervës ndërkombëtare neto.

Kuadri i objektivave të politikës monetare plotësohet me përcaktimin e objektivave operacionalë të politikës monetare. Këta vendosin një lidhje më të ngushtë midis operacioneve të politikës monetare, objektivit të saj të ndërmjetëm dhe atij kryesor, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Objektivat operacionalë për vitin 2006, janë mjetet e brendshme neto të

Bankës së Shqipërisë dhe rezervat ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë. Për secilin nga këta objektiva është vendosur një nivel sasior kundrejt të cilit kontrollohet puna e bërë për arritjen e tyre. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë, për efekte të politikës monetare, ndjek dhe monitoron edhe kreditin e brendshëm neto për qeverinë, ndonëse ky nuk është objektiv operacional i saj.

- Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë përfaqësojnë shumën e pretendimeve të Bankës së Shqipërisë, përjashtuar pretendimet valutore të saj ndaj jorezidentëve. Më konkretisht, këtu bëjnë pjesë pretendimet e Bankës së Shqipërisë ndaj Qeverisë (për neto) si dhe pretendimet e Bankës së Shqipërisë ndaj bankave të nivelit të dytë. Për to vendoset një kufi i sipërm, që do të thotë se Banka e Shqipërisë nuk mund të rrisë gjendjen e mjeteve të brendshme neto përtej shifrës së vendosur kufi.
- Rezervat ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë përfaqësojnë mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë minus të gjitha zotërimet valutore të bankave të nivelit të dytë të vendosura në Bankën e Shqipërisë (rezerva të detyruara në valutë plus rezervat e tepërta në valutë). Për to vendoset një kufi i poshtëm dhe përlllogaritjet bazohen në kursin e këmbimit të fundit të muajit dhjetor të vitit 2003.
- Krediti i brendshëm neto për Qeverinë përfaqëson totalin e pretendimeve të sistemit bankar ndaj qeverisë, minus depozitat e kësaj të fundit si në Bankën e Shqipërisë ashtu dhe në bankat e nivelit të dytë. Vendosja e një niveli kufi të sipërm ka si synim të vërë nën kontroll, brenda niveleve të paracaktuara, kreditimin e deficitit buxhetor nga ana e sistemit bankar. Për vitin 2006, kufiri i sipërm i financimit të brendshëm të deficitit buxhetor është 23.8 miliardë lekë.

Këto nivele sasiore rishikohen gjatë vitit, në përputhje me ecurinë e zhvillimeve monetare dhe të masave korrektuese të propozuara nga Banka e Shqipërisë në programin monetar.

Në përputhje me zgjerimin dhe me rritjen e konkurrencës në tregun bankar shqiptar, Banka e Shqipërisë do t'i kushtojë një rëndësi në rritje kontrollit të normave të interesit në tregun ndërbankar. Ndonëse ato nuk do të shërbejnë si një objektiv operacional i Bankës së Shqipërisë, normat e interesit të tregut ndërbankar janë një tregues i gjendjes monetare në ekonomi dhe një përcaktues i rëndësishëm i zhvillimit të ekonomisë.

INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Banka e Shqipërisë do të mbështetet në instrumentet indirekte të politikës monetare për të përmbushur objektivat e saj. Instrumentet e politikës monetare do të orientohen drejt përmbushjes së objektivave operacionalë të Bankës së Shqipërisë. Në përputhje me parimet e politikës monetare për vitin 2006, të paracaktuara më parë në këtë dokument, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë aplikimin e një regjimi fleksibël të kursit të këmbimit.

- Operacionet e tregut të hapur³.

Operacionet e tregut të hapur kanë për qëllim administrimin e normave të interesit në ekonomi, administrimin e gjendjes së likuiditetit në treg si dhe sinjalizimin e politikës monetare.

Operacionet e tregut të hapur përfshijnë:

- marrëveshjet e riblerjeve dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjeve;
- transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota;
- operacionet në tregun valutor.

Instrumenti kryesor që përdoret për të përçuar sinjalet e politikës monetare është norma e interesit, që aplikohet në marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes me afat njëjavor⁴. Norma e interesit e aplikuar nga Banka e Shqipërisë në këto operacione luan rolin e normës bazë të interesit në ekonomi. Norma bazë e interesit vendoset nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe përdoret nga Banka e Shqipërisë në ankandet javore të marrëveshjeve të riblerjes (repove). Kjo normë përcakton edhe normën e interesit të depozitave dhe të huave njëditore të Bankës së Shqipërisë. Ajo ndikon normën e interesit të tregut ndërbankar, të depozitave në lekë pranë bankave tregtare si dhe të bonove të thesarit dhe të kredisë së akorduar në lekë për ekonominë.

Lehtësitë e përhershme.

Lehtësitë e përhershme ndikojnë në gjendjen e likuiditetit në sistemin bankar dhe pengojnë luhatjet e mëdha të normave të interesit. Lehtësitë e përhershme realizohen gjithmonë dhe ekskluzivisht me nismën e bankave të nivelit të dytë. Palë e Bankës së Shqipërisë në këto operacione janë vetëm bankat e nivelit të dytë.

Lehtësitë e përhershme të ofruara nga Banka e Shqipërisë janë:

- depozita njëditore;
- kredia njëditore;
- kredia lombard.

Rezerva e detyruar.

Rezerva e detyruar është një instrument me anë të të cilit Banka e Shqipërisë i detyron bankat e nivelit të dytë, të vendosin një rezervë të caktuar në lekë dhe në valutë pranë saj. Nëpërmjet këtij instrumenti Banka e Shqipërisë synon në rregullimin e ofertës së parasë, të likuiditeteve dhe të normës së interesit në sistemin bankar si dhe në ruajtjen e sigurisë së sistemit.

* * *

Banka e Shqipërisë, në varësi të kushteve të tregut financiar shqiptar dhe të nevojave të politikës monetare do të vazhdojë të rishikojë në vazhdimësi

instrumentet e saj të politikës monetare. Këto rishikime do të bëhen me synimin e rritjes së eficiencës së përdorimit të tyre.

* * *

KOMUNIKIMI I VENDIMEVE TË POLITIKËS MONETARE.

Politika monetare dhe vendimet e marra në zbatim të saj i komunikohen publikut nëpërmjet këtyre dokumenteve:

- Dokumenti i politikës monetare që përshkruan parimet kryesore të kësaj politike të miratuar për një vit.
- Deklarata e politikës monetare, e cila përshkruan zhvillimet monetare në gjashtë muajt e kaluar dhe perspektivën për gjashtë muajt e ardhshëm.
- Opinion mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit, ku jepen zhvillimet tremujore ekonomike dhe monetare.
- Raporti mujor i politikës monetare, i cili përshkruan zhvillimet monetare mujore dhe jep vlerësimin mbi qëndrimin që duhet mbajtur në të ardhmen.
- Publikimi i vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në lidhje me normat e interesit brenda 48 orëve nga marrja e vendimit.
- Konferencat e shtypit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë për të komunikuar dhe shpjeguar vendimet e politikës monetare.

Gjithashtu, komunikimi i politikës monetare realizohet edhe nëpërmjet publikimit të të gjitha rregulloreve dhe akteve të tjera, që kanë të bëjnë me instrumentet e përdorura për zbatimin e politikës monetare.

FJALOR

MARRËVESHJET E RIBLERJES / TË ANASJELLTA TË RIBLERJES.

Këto marrëveshje përbëjnë një instrument me anë të të cilit Banka e Shqipërisë tërheq ose hedh përkohësisht likuiditet në sistemin bankar. Marrëveshja e riblerjes është një instrument që përdoret për të pakësuar përkohësisht likuiditetin në sistemin bankar. Marrëveshja e anasjelltë e riblerjes përbën një instrument që përdoret për të shtuar përkohësisht likuiditetin në sistemin bankar ose aftësinë e bankave për të rritur kredihënien apo për të rritur paranë në qarkullim. Marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve me afat njëjavor realizohen nëpërmjet ankandëve standarde. Ndërsa marrëveshjet me afat njëditor, njëmujor dhe tremujor realizohen nëpërmjet ankandëve të shpejta.

TRANSAKSIONET E SHITBLERJEVE ME TË DREJTA TË PLOTA.

Banka e Shqipërisë, pakëson likuiditetin në treg nëpërmjet transaksioneve të shitjeve me të drejta të plota dhe e shton atë nëpërmjet transaksioneve të blerjeve me të drejta të plota. Këto transaksione kryhen në formën e blerjeve

apo të shitjeve të bonove të thesarit me afat maturimi deri një vit apo të letrave të borxhit me kredibilitet të lartë.

OPERACIONET NË TREGUN VALUTOR.

Operacionet në tregun valutor kryhen nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet blerjes dhe shitjes së valutës në treg, kur ajo synon të veprojë në treg. Këto operacione kryhen në funksion të përmbushjes së politikës së përcaktuar në këtë dokument.

DEPOZITA NJËDITORE.

Depozita njëditore ndihmon bankat e nivelit të dytë të veprojnë me likuiditetin e tepërt, duke e depozituar atë vetëm për një ditë në Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu, depozita njëditore ndihmon në tërheqjen e likuiditetit të tepërt nga sistemi bankar dhe në zbutjen e luhatjeve të mëdha në normat afatshkurtra të interesit. Norma e interesit për depozitën njëditore përfaqëson normën më të ulët të interesit në treg, që ofrohet nga Banka e Shqipërisë.

KREDIA NJËDITORE.

Kredia njëditore është një kredi plotësisht e garantuar, që akordohet për të ndihmuar bankat e nivelit të dytë të zgjidhin problemet njëditore të likuiditetit. Gjithashtu, ajo ndihmon për të zbutur luhatjet e normave afatshkurtra të interesit. Norma e interesit të kredisë njëditore është më e lartë se norma bazë e interesit.

KREDIA LOMBARD.

Kredia lombard përdoret për të ndihmuar bankat e nivelit të dytë të kapërcejnë problemet e përkohshme të likuiditetit. Kjo është kredi plotësisht e garantuar me afat maturimi deri në tre muaj. Norma e interesit të kësaj kredie përfaqëson normën më të lartë të interesit të vendosur nga Banka e Shqipërisë.

SHËNIME

- ¹ Sipas amendamentit të bërë me ligjin nr. 8893, datë 25. 07. 2002.
- ² Banka Qendrore Evropiane synon të ruajë inflacionin afër, por jo më shumë, se niveli 2 për qind në një periudhë afatmesme.
- ³ Në fjalorin bashkëngjitur jepet një sqarim më i detajuar i funksionimit të instrumenteve monetare.
- ⁴ Operacionet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes njihen respektivisht si repo dhe repo të anasjellta.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.101, datë 28.12. 2005

PËR

PAJISJEN ME LICENCË PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BANKARE,
TË "BANKËS UNION SH.A.".

Në mbështetje të nenit 43 shkronja "e", të nenit 3, pika 4 shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të nenit 10 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të pajisë me licencë për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, "Bankën Union sh.a.".
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

YLLI MEMISHA

KRYETARI

ARDIAN FULLANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.102, datë 28.12.2005

PËR

MIRATIMIN E UDHËZIMIT "PËR KUSHTET MINIMALE TEKNIKE DHE TË
SIGURISË TË MJEDISEVE TË PUNËS SË SUBJEKTEVE QË LICENCOHEN
NGA BANKA E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997
"Për Bankën e Shqipërisë" me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes
dhe të Departamentit të Sigurimit dhe të Mbrojtjes në Bankën e Shqipërisë,
Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë udhëzimin "Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve të punës së subjekteve që licencohen nga Banka e Shqipërisë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes në Bankën e Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

UDHZIËM

“PËR KUSHTET MINIMALE TEKNIKE DHE TË SIGURISË TË MJEDISEVE TË PUNËS SË SUBJEKTEVE QË LICENCOHEN NGA BANKA E SHQIPËRISË”.

BAZA LIGJORE

Neni 1

Ky udhëzim nxirret në mbështetje të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” neni 12, shkronja “a” dhe neni 70, pika 1, si edhe të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” neni 10, paragrafi 4, shkronja “b”.

PËRCAKTIME

Neni 2

- (1) Me termin “kushte teknike” kuptohen:
 - a) kushtet për mbrojtjen e paprekshmërisë fizike të të gjitha mjediseve ku zhvillon veprimtarinë subjekti (duke përfshirë mbrojtjen elektronike dhe atë me personel) dhe të personave që i përdorin këto mjedise;
 - b) procedurat për mbrojtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit;
 - c) kërkesat për fillimin dhe zhvillimin e veprimtarisë operacionale të subjektit;
- (2) Me termin “aksesorë të sporteve”, kuptohen sirtarët dhe/ose kasafortat apo minikasafortat, që sportelistët e subjektit përdorin për të vendosur vlerat monetare fizike dhe/ose dokumentet që iu nevojiten gjatë një transaksioni me klientin në sportel.
- (3) Me termin “sportelistë”, kuptohen punonjësit e subjektit që në mënyrë permanente ofrojnë shërbimet e subjektit për klientët, në sportelin e subjektit.
- (4) Me termin “vija e sportelit” në mjedisin e punës së subjektit, kuptohet vija ndarëse mes zonës së sportelit dhe zonës së pritjes së klientit.

QËLLIMI

Neni 3

- (1) Standardet e përfshira në këtë udhëzim, synojnë që subjekti i tyre:
 - a) të ketë kushtet minimale teknike për fillimin dhe zhvillimin e veprimtarisë në mënyrë normale;

- b) të jetë i përgatitur për të parandaluar aktet e thyerjes së sigurisë fizike;
 - c) të jetë i përgatitur për të vepruar në kushtet e thyerjes së sigurisë fizike.
- (2) Në zbatimin e këtyre standardeve, subjekti i tyre, duhet të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme, të cilat plotësojnë njëri-tjetrin:
- a) krijimi i një mjedisi sa më të përshtatshëm për pritjen dhe shërbimin komod dhe të kulturuar ndaj klientit;
 - b) krijimi i kushteve të nevojshme për sigurimin e paprekshmërisë fizike të personave që gjenden në mjedisin e punës së subjektit, për shkak të qëllimit të tyre, që në mënyrë normale të kryejnë dhe/ose të përfitojnë shërbimet që kërkon dhe/ose që ofron ai;
 - c) marrjen e të gjitha masave për minimizimin e dëmeve materiale dhe financiare, në rastin e thyerjeve të kushteve të sigurisë;
 - d) zbatimin e këtyre standardeve në të gjithë rrjetin e subjektit, në varësi të perceptimit të tij për nivelin e rrezikut dhe të vëllimit të veprimtarisë në institucionet e rrjetit.
- (3) Duke qenë se ky udhëzim përmban standardet minimale në vendosjen dhe në ruajtjen e kushteve të sigurisë teknike, subjekti i tyre pritët që në praktikë, t'i zbatojë këto standarde në një nivel më të lartë dhe në mënyrë të përgjegjshme.

SUBJEKTET

Neni 4

- (1) Subjekte të këtyre standardeve janë institucionet e licencuara ose që kanë aplikuar për licencë në Bankën e Shqipërisë (në vijim, subjekti/subjektet), duke përfshirë shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre. Për zyrat e këmbimit valutor, këto standarde përcaktohen në mënyrë të specifikuar në nenin 11.
- (2) Pavarësisht nga përcaktimet e paragrafit (1), përcaktimet e këtij udhëzimi do të shërbejnë si standarde referuese për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre në sigurimin e kushteve teknike në përputhje me natyrën e veprimtarisë së tyre, me vëllimin e saj dhe me nivelin e vlerësuar të rrezikut për thyerje të kushteve të sigurisë.
- (3) Në të gjithë përmbajtjen e këtij udhëzimi, në çdo rast që subjekti kërkohet të veprojë, do të kuptohet që strukturat e tij drejtuese dhe vendimmarrëse ose njësitë organizative, punonjësit, agjentët dhe çdo person tjetër i autorizuar prej tyre, duhet ta kryejë atë veprim. Në çdo rast të një personi të autorizuar nga subjekti, procedurat e autorizimit dhe vetë autorizimi, duhet të jenë të dokumentuara.

AKTET E BRENDSHME

Neni 5

- (1) Subjekti duhet të ketë politika dhe procedura të hartuara dhe të miratuara nga këshilli drejtues (ose një strukturë tjetër e autorizuar prej tij), për kushtet teknike dhe të sigurisë në të cilat kryen veprimtarinë e tij. Këto procedura, duhet të përfshijnë minimalisht:
 - a) mënyrën e realizimit të mbrojtjes së veprimtarisë së tij, duke përfshirë mënyrën e përzgjedhjes së mjediseve ku vendoset për të kryer veprimtarinë dhe të sigurimit financiar të tyre, të ruajtjes me personel dhe të ruajtjes elektronike, të administrimit të vlerave monetare fizike dhe të sigurimit financiar të këtyre vlerave, të marrëdhënieve me institucione të tjera për plotësimin e kuadrit të mbrojtjes së veprimtarisë etj.;
 - b) hallkat dhe/ose njësitë përgjegjëse për realizimin e këtyre procedurave dhe mënyrën e veprimit të tyre në kushte normale dhe në raste të thyerjes së kushteve të sigurisë dhe mënyrën e ndërveprimit mes tyre;
 - c) mënyrën e administrimit të dokumentacionit që lidhet me mbrojtjen e veprimtarisë.
- (2) Në qendër, në degë dhe në agjenci, në përputhje me natyrën dhe vëllimin e veprimtarisë, subjekti cakton një person përgjegjës për zbatimin e tyre, sipas këtij udhëzimi dhe sipas akteve të tij të brendshme të miratuara. Subjekti merr masa që të organizojë një njësi të veçantë përgjegjëse për zbatimin e kërkesave teknike (sipas natyrës së tyre), nëse gjykon që përmasat e veprimtarisë së tij dhe problematika e shfaqur, e kërkojnë një gjë të tillë.
- (3) Procedurat e subjektit për kushtet teknike dhe të sigurisë, përcaktojnë gjithashtu personat përgjegjës, linjat e raportimit dhe të njoftimit si edhe mënyrën e kryerjes së kontroleve periodike gjatë orarit të punës, para nisjes dhe në mbyllje të ditës së punës, në ditët e pushimit etj..
- (4) Subjekti merr masa që politikat, procedurat dhe aktet e ndryshme të miratuara në fushën e plotësimit të kërkesave teknike dhe të sigurisë, të njihen maksimalisht nga punonjësit e rëndësishëm në të gjithë strukturën dhe rrjetin e tij. Për këtë qëllim, subjekti duhet të realizojë trainime të ndryshme si edhe testime të mënyrës së veprimit në zbatim të kërkesave të këtij udhëzimi dhe në raste të supozuara të thyerjes së forcuar ose të rastësishme të kërkesave të sigurisë.
- (5) Subjekti merr masa që procedurat e tij të sigurimit të kushteve teknike dhe të sigurisë, të mbulojnë të gjitha mundësitë e parashikuara të thyerjes së tyre, si edhe realizon rishikimin dhe pasurimin e këtyre procedurave në mënyrë periodike.
- (6) Subjekti merr masa që sistemet e tij të mbrojtjes dhe ndërveprimi mes hallkave përgjegjëse që mundësojnë funksionimin e tyre, të jenë funksionale gjatë gjithë kohës së nevojshme. Pjesë e këtyre masave janë

edhe aktmarrëveshjet ose kontratat për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të mbrojtjes, me ofruesit e jashtëm të këtyre sistemeve.

KUSHTET PËR MBROJTJEN E PAPREKSHMËRISË FIZIKE

Neni 6

Për të disiplinuar zhvillimin e veprimtarisë së subjektit në kushte sa më të sigurta, me qëllim parandalimin dhe/ose minimizimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme, që kanë si pasojë rrezikimin e jetës së punonjësve të subjektit dhe të klientëve, si edhe grabitjen e vlerave monetare, subjekti duhet të plotësojë minimalisht këto kërkesa:

- (1) Në kushtet e tij për përzgjedhjen e mjediseve që do t'i shfrytëzojë për të kryer veprimtarinë, subjekti duhet të përfshijë edhe kërkesa që lidhen me nevojën që këto mjedise të jenë të sigurta nga penetrimet e paautorizuara në të gjithë perimetrin dhe sipërfaqen e tyre të jashtme, të jenë të dukshme pranë rrugëve kryesore dhe qendrave të banuara, të jenë lehtësisht të arritshme nga njësitë e institucioneve të specializuara në raste të thyerjes me forcë të sigurisë fizike dhe në raste të rënies së zjarrit, të ofrojnë kushtet e nevojshme të hapësirës, të temperaturës, të dritës dhe të lagështisë për punonjësit, për klientët, për mirëmbajtjen e vlerave monetare fizike etj..
- (2) Subjekti merr masa që të gjithë punonjësit e tij të jenë të identifikueshëm gjatë gjithë kohës së punës. Identifikimi paraprin dhe shoqëron procesin e autorizimit për përdorimin e sistemeve të caktuara, të mjediseve të caktuara, të materialeve dhe të dokumenteve të caktuara, aksesimi i të cilave nuk është i lejuar për çdo punonjës të subjektit.
- (3) Subjekti merr masat e nevojshme që në mjedisin e tij të punës, të jenë qartësisht të dallueshme:
 - a) zona e pritjes së klientit;
 - b) zona e sportelit (ku këmbëhen vlerat monetare fizike me klientët);
 - c) zona e administrimit dhe e ruajtjes së vlerave monetare fizike (dhoma-kasafortë, mjediset ku përpunohet *cash*-i);
 - d) zona ku janë të vendosura zyrat e administratorëve dhe të personelit.
- (4) Subjekti duhet të sigurojë ndarjen e punëve në këto zona dhe të realizojë ndalimin e lëvizjeve të paautorizuara dhe kufizimin e lëvizjeve të pajustificuara, veçanërisht në zonën e sportelit si edhe në zonën e administrimit dhe të ruajtjes së vlerave monetare fizike. Në kushte normale, të gjitha veprimet për administrimin e vlerave monetare nga ana e subjektit, që nuk përfaqësojnë transaksione me klientët, duhet të kryhen në zonën e administrimit dhe të ruajtjes së vlerave monetare fizike.
- (5) Subjekti, sipas nivelit të perceptuar të rrezikut, merr masa që të krijojë një mjedis të sigurtë për klientët e tij që kryejnë veprime në vlera monetare. Këto masa, mund të përfshijnë krijimin e mjediseve të veçanta për kryerjen e veprimeve nga klientët, si edhe vendosjen e sistemeve fizike dhe/ose elektronike, të cilat mundësojnë parandalimin, identifikimin dhe

ndalimin e mjeteve dhe të personave që, me hyrjen e tyre në mjediset e punës së subjektit, rrezikojnë kryerjen në mënyrë normale dhe të sigurtë të veprimtarisë së tij.

- (6) Subjekti merr masat e nevojshme, që zona e sportelit ku janë të vendosur sportelistët, të sigurojë kryerjen e veprimeve me klientët në mënyrë të sigurtë për sportelistët dhe të sigurojë transparencën e nevojshme për klientin. Për këtë qëllim, subjekti duhet të zbatojë procedura të brendshme të cilat përfshijnë kërkesat për sigurimin fizik të kësaj zone dhe ndalimin e hyrjes së personave të paautorizuar, për shmangien e mbajtjes së sasive të tepërta të vlerave monetare fizike në aksesoret e sporteleve dhe ruajtjen e këtyre të fundit, si edhe kërkesat për të respektuar largësinë dhe ndarjen e nevojshme të sigurisë mes aksesoreve të sportelit/sportelistëve dhe klientëve, në vijën e sportelit. Në varësi të nivelit të perceptuar të rrezikut, ndarja në vijën e sportelit mund të kryhet edhe me material të fortë dhe transparent, me lartësinë dhe fortësinë minimale të nevojshme për të mundësuar mbrojtjen sipas këtij paragrafi.
- (7) Zona e administrimit dhe e ruajtjes së vlerave monetare fizike, përfaqësohet nga dhoma (hapësira e kufizuar) në të cilën vendosen vlerat monetare. Subjekti merr masa që dhoma të jetë hermetikisht e izoluar me material të fortë, e cila mbron në mënyrë uniforme nga penetrimi fizik duke shërbyer si një dhomë kasafortë. Nëse kjo nuk mund të realizohet për arsye objektive, subjekti merr masa që brenda saj të vendosen kasaforta të posaçme (me përbërje dhe trashësi, me përmasa dhe me peshë të caktuar, të cilat e bëjnë pothuaj të pamundur hapjen ose lëvizjen e paautorizuar të tyre), brenda të cilave vendosen vlerat monetare. Subjekti duhet të përcaktojë dhe të zbatojë procedura lidhur me personat që autorizohen të hyjnë në dhomën-kasafortë dhe për mënyrën e administrimit të saj nga këta persona, me qëllim që procedurat të kryhen në mënyrë plotësuese dhe të ndara në më shumë se një person i autorizuar. Gjithashtu, subjekti merr masa për monitorimin elektronik nga jashtë dhe brenda të dhomës-kasafortë dhe të personave që kanë hyrë brenda saj.
- (8) Subjekti merr masa edhe për monitorimin dhe mbrojtjen e zonës ku janë të vendosura zyrat e administratorëve dhe të personelit. Procedurat e subjektit në këtë rast duhet të përfshijnë edhe përcaktimin e mënyrës së hyrjes në këto mjedise të personave të jashtëm dhe të ruajtjes së dokumentacionit të rëndësishëm.
- (9) Kur subjekti e zhvillon veprimtarinë në mjedise të përbashkëta (holle, salla etj.), me qarkullim të madh të personave gjatë gjithë ditë-natës, atëherë është e nevojshme që:
 - a) sipërfaqja ku subjekti kryen veprimtarinë, të jetë e kufizuar dhe e ndarë nga pjesa tjetër e mjedisit të përbashkët ku është vendosur subjekti;
 - b) të sigurohet në mënyrë parësore zona e sportelit të subjektit, veçanërisht në rastet kur, për shkak të konfiguracionit të mjedisit të përbashkët subjekti nuk mund të realizojë një sallë pritjeje për klientët, faqet anësore të së cilës të shërbejnë si perimetër i jashtëm mbrojtës. Në këtë rast, subjekti

- pritet të marrë të gjitha masat për izolimin fizik të të gjithë perimetrit të zonës së sportelit, në gjatësinë dhe në lartësinë maksimale.
- c) dhoma-kasafortë ku vendosen dhe/ose administrohen vlerat monetare, për pjesën e perimetrit të saj i cili nuk kufizohet me mjedise të tjera të subjektit, do të jetë e rrethuar (ose do të mbështetet) nga material i fortë;
 - d) kasafortat duhet të jenë të vendosura në dhomën kasafortë, e cila duhet të jetë e mbyllur me portë të fortë;
 - e) pjesa tjetër e mjediseve të subjektit, mund të jetë e rrethuar në këtë rast me material të fortë transparent.

Kur vendosja e mjediseve të punës së subjektit është në disa kate, atëherë subjekti siguron që lidhja vertikale e tyre me shkallë dhe me ashensor, të jetë më vehte.

MBROJTJA ELEKTRONIKE

Neni 7

- (1) Subjekti duhet të marrë të gjitha masat që të vendosë një impiant të sistemit të mbrojtjes elektronike në hapësirat e brendshme të mjediseve ku zhvillon veprimtarinë e tij. Sistemi i mbrojtjes elektronike duhet të sigurojë edhe monitorimin e sipërfaqeve të jashtme perimetrale të objektit ku profili i rrezikut është i lartë (për shembull, dritaret në pjesën e pasme, zonat e vendosjes së burimit të energjisë elektrike, të karburantit etj.). Si rregull, impianti i mbrojtjes elektronike do të përbëhet nga sistemi i vrojtimit, sistemi i mbrojtjes me sensorë dhe sistemi i sinjalizimit.
- (2) Sistemi i vrojtimit përfshin qarkun e mbyllur televiziv (CCTV), si edhe:
 - a) telekamera, të cilat duhet të filmojnë në mënyrë të pandërprerë hyrjen për në mjediset e përgjithshme të punës së subjektit, sportelin nga brenda dhe nga jashtë, dhomën-kasafortë për të vrojtuar personat që afrohen për hapjen e saj, rrugëkalimet për në mjedisin e dhomës-kasafortë, mjediset ku janë vendosur serverat e sistemit të teknologjisë së informacionit;
 - b) videoregjistrator, i cili të shërbejë për regjistrimin e informacionit të dërguar nga telekamerat. Subjekti merr masa që videoregjistratori të vendoset (të ruhet) në një vend të sigurtë dhe të fshehtë, në mënyrë që të mos dëmtohet në rast abuzimi apo të grabitet.
 - i. Pamjet e regjistruara në videoregjistrator, duhet të ruhen në një pajisje të posaçme (për shembull, një kompjuter), e cila duhet të përdoret vetëm për qëllime të mbrojtjes elektronike dhe jo për qëllime të tjera që lidhen me veprimtarinë e subjektit.
 - ii. Koha e ruajtjes së kasetave të regjistruara dhe mënyra e përdorimit të regjistratorit përcaktohen me udhëzim të veçantë të miratuar nga subjekti. Koha e ruajtjes së regjistrimeve, në kushte normale nuk duhet të jetë më pak se 60 ditë;
 - c) monitor, për shikimin e pamjeve të telekamerave, i cili si rregull duhet të jetë i vendosur në mjedisin e punës së drejtuesit të njësisë ose një punonjësi tjetër të autorizuar nga subjekti për çështjet e sigurisë;

- d) aksesorët e nevojshëm për funksionimin normal të CCTV-së;
 - e) buton (pedanë) alarmi të instaluar në zonën ku vendoset monitori, me qëllim që monitoruesi të evidentojë dhe të njoftojë menjëherë shoqërinë që ofron shërbimin e ruajtjes dhe të sigurimit fizik dhe/ose Policinë e Shtetit, në rast ngjarjesh të jashtëzakonshme në mjediset e vrojtura të subjektit.
- (3) Sistemi i mbrojtjes me sensorë, që si rregull duhet të përfshijë:
- a) sensorë volumetrikë, që si rregull instalohen në të gjitha mjediset e brendshme. Sensorët volumetrikë, do të mbulojnë zonën ku është vendosur dhoma-kasafortë (ose kasaforta kryesore);
 - b) sensorë sizmikë, të instaluar në dhomën-kasafortë apo në paretet rrethuese ku është vendosur kasaforta kryesore e vlerave monetare, si edhe në të gjitha sipërfaqet perimetrale të mjedisit të subjektit të cilat kufizohen me mjedise të subjekteve të tjera, publike dhe jopublike;
 - c) sensorë të mbrojtjes së xhamave në ato raste kur këta përbëjnë sipërfaqe të konsiderueshme;
 - d) kontakte magnetike, të instaluar në dyert e dhomës kasafortë, në hyrjen e zonës së sportelit dhe në hyrjen kryesore, si edhe në dritaret e pjesës së pasme të objektit nëse janë të lëvizshme (hapen dhe mbyllen);
 - e) sensorë të mbrojtjes nga zjarri, të instaluar në të gjithë mjedisin e subjektit. Subjekti merr masa që sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit, i cili përfshin sensorët e zjarrit dhe infrastrukturën (pajisje dhe rrjete) që mundëson minimalisht dërgimin e shpejtë të sinjalit të alarmit pranë njësisë së mbrojtjes kundër zjarrit dhe personave të tjerë të rëndësishëm, të jetë funksional gjatë 24 orëve.
- (4) Sistemi i sinjalizimit, që si rregull duhet të përfshijë:
- a) sirenë alarmi të brendshme dhe të jashtme;
 - b) butona (pedana) alarmi të instaluar në tavolinat e punës të punonjësve të sportelit dhe të zonës së administrimit të vlerave monetare fizike, në tavolinën e punës së drejtuesit dhe në zonën ku vepron punonjësi i sigurimit të brendshëm;
 - c) central të alarmit;
 - d) kombinatori telefonik për dërgimin e sinjalit të alarmit në telefonat e drejtuesve të subjektit, të sallës operative ose të drejtuesve të shoqërisë që ofron shërbimin e ruajtjes dhe të sigurimit fizik për subjektin, punonjësve që disponojnë çelësat dhe kodin numerik të kombinatorit të kasafortës (kur zbatohet), sallën operative të komisarariatit të Policisë së Shtetit;
 - e) aksesorë të nevojshëm që mundësojnë funksionimin e alarmit.
- (5) Subjekti duhet të marrë masa që të sigurojë funksionimin e pandërprerë të impiantit të mbrojtjes elektronike. Të tilla masa, përfshijnë edhe instalimin e burimeve alternative të energjisë.
- (6) Është e nevojshme që midis subjektit dhe institucioneve të specializuara publike dhe private që i ofrojnë shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike ose që e asistojnë në këtë fushë, të përcaktohen në mënyrë të dokumentuar marrëdhëniet dypalëshe, duke përfshirë edhe mënyrën e dërgimit të sinjalit si edhe të veprimeve dypalëshe në rast alarmi.

MBROJTJA ME PERSONEL

Neni 8

- (1) Në institucionet e rrjetit të subjektit, ku niveli i perceptuar i rrezikut dhe vëllimi i veprimtarisë është i rëndësishëm, duhet të merren masat për ruajtjen dhe sigurimin me personel të mjediseve të punës. Ruajtja dhe sigurimi me personel përfshin:
 - a) sigurimin e jashtëm, ku subjekti siguron që ky shërbim të realizohet në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr.8770, datë 14.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike" si edhe të akteve normative të miratuara në zbatim të tij. Marrëdhëniet e subjektit me personin juridik që ofron shërbimin e sigurisë, duke përfshirë detyrimet e secilës palë dhe modalitetet e kryerjes së shërbimit, duhet të jenë të dokumentuara;
 - b) sigurimin e brendshëm, i cili, si rregull, kryhet nga punonjësit e sigurimit të brendshëm të subjektit. Në procedurat që rregullojnë mënyrën e veprimit të sigurimit të brendshëm, duhet të parashikohen edhe kërkesa që lidhen me mënyrën e aksesit të tij në zona të veçanta të mjedisit të punës në subjekt. Subjekti merr masa që të evitohet mundësitë që ekzistojnë që të drejtat e personelit të sigurimit të brendshëm ose armatimi i tij, të përdoren për thyerje të brendshme të sigurisë.

TRAJTIMI I VLERAVE MONETARE FIZIKE (CASH-I)

Neni 9

- (1) Subjekti merr masa që të mos mbajë në sportelet e institucioneve të rrjetit të tij, sasi të vlerave monetare fizike që kapërcejnë në mënyrë të pajustificueshme sasi të që i nevojiten gjatë ditës së punës për nevojat e tij në marrëdhëniet me klientët. Subjekti merr të gjitha masat që, në varësi të nevojave të përgjithshme të tij, një parim i tillë të zbatohet edhe për vlerat monetare fizike që ruhen në dhomën-kasafortë.
- (2) Subjekti, në përputhje me procedurat që zbatohen shoqëritë e sigurimit financiar të licencuara dhe të autorizuar për të ofruar shërbimin e sigurimit financiar të vlerave monetare, realizon sigurimin financiar të vlerave monetare fizike që i përkasin, në gjendje stoku dhe/ose në udhëtim. Polica e sigurimit financiar në këtë rast, përveç mbulimit të elementeve të tjera, duhet të përfshijë specifikisht sigurimin e vlerave monetare nga humbjet që shkaktohen si rezultat i thyerjes së kushteve të sigurisë. Marrëdhëniet e subjektit me shoqërinë e sigurimit financiar, duke përfshirë detyrimet e secilës palë dhe modalitetet e përfitimit të policës dhe të dëmshpërblimit, duhet të jenë të dokumentuara.
- (3) Subjekti merr masa që të transportojë në mënyrë të sigurtë vlerat monetare fizike. Në procedurat e brendshme për këtë qëllim, duhet të jenë të përcaktuara mënyra e lëvizjes së informacionit, mënyra e kryerjes së këtij transporti, personat e jashtëm që e ofrojnë shërbimin e transportit dhe të ruajtjes së ngarkesës, mjetet që përdoren për transport dhe cilësia

e tyre etj.. Për shërbimin e transportimit të vlerave monetare fizike, subjekti sigurohet që ky shërbim realizohet në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr.8770, datë 14.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike" si edhe të akteve normative të miratuara në zbatim të tij. Marrëdhëniet e subjektit me personat juridikë të jashtëm që e ofrojnë shërbimin, duke përfshirë detyrimet e secilës palë dhe modalitetet e përfitimit të shërbimit, duhet të jenë të dokumentuara.

MBROJTJA E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Neni 10

- (1) Për zhvillimin normal të veprimtarisë së tij, subjekti duhet të ketë politika dhe procedura të miratuara për ruajtjen fizike dhe nga penetrimet në rrjet, të sistemeve të teknologjisë së informacionit, si edhe për rivendosjen në punë të tyre në kushtet e cënimit të veprimtarisë normale nga ngjarje të jashtëzakonshme.
- (2) Procedurat e ruajtjes së sistemeve të teknologjisë së informacionit duhet të synojnë identifikimin dhe mbrojtjen nga aksesimi i paautorizuar, në mënyrë fizike dhe/ose nga penetrimi në rrjet, minimalisht të:
 - a) arkitekturës së rrjetit të teknologjisë së informacionit;
 - b) serverave dhe mjediseve të vendosjes së tyre, pajisjeve kompjuterike dhe mediave të *backup-it*, të softeve që do të përdoren dhe të vlerësimit të përshtatshëm të tyre;
 - c) planit të veprimit në raste të jashtëzakonshme;
 - d) mënyrave të lidhjes *online* me degët dhe agjencitë, dhe linjat dytësore për lidhjet me to;
 - e) përkrahjeve të punës së personave që do të merren me administrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit;
 - f) procedurave dhe të pajisjeve të ruajtjes së të dhënave;
 - g) programit të sigurisë së sistemit;
 - h) strategjisë së zhvillimit të sistemit të teknologjisë së informacionit;
 - i) procedurave të mbështetjes teknike të degëve dhe të agjencive;
 - j) vlerësimit të rrezikut në lidhje me teknologjinë e informacionit;
 - k) procedurave të administrimit të ndryshimeve të sistemit;
 - l) proceseve të monitorimit të sistemit;
 - m) kontratave me ofrues të jashtëm të shërbimit të teknologjisë së informacionit;
 - n) elementeve të tjera, që subjekti i gjykon të nevojshme.
- (3) Kërkesat e nenit (5), paragrafet (4) dhe (6), zbatohen edhe në këtë rast.

KËRKESAT PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE OPERACIONALE

Neni 11

- (1) Krahas plotësimit të kërkesave të neneve 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10, për fillimin dhe zhvillimin e veprimtarisë operacionale në kushte normale, subjekti duhet të sigurojë që në fillim të veprimtarisë së tij, dhe të mbajë më tej në

funksionim:

- a) kompjutera, printera dhe aksesorët e tyre;
- b) programe informatike në mbështetje të veprimtarisë së parashikuar;
- c) tavolina pune;
- d) telefon;
- e) faks;
- f) teleks;
- g) makina sortuese dhe makina të numërimit të parave;
- h) makina dhe pajisje të verifikimit të parave;
- i) tabela të shfaqjes për publikun të niveleve të normave të interesit, të komisioneve, të kursit të këmbimit, informacione të ndryshme;
- j) modularët për veprimet në sportel;
- k) lajmërimet përmbledhëse dhe fletëpalosjet informuese;
- l) të tjera, që subjekti i gjykon të nevojshme.

KUSHTET TEKNIKE DHE TË SIGURISË PËR ZYRAT E KËMBIMIT VALUTOR

Neni 12

- (1) Kërkesat e përcaktuara në nenin 6, me përjashtim të atyre që bien në kundërshtim me paragrafin (2) të këtij neni, do të zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe në rastin e zyrës së këmbimit valutor, në përputhje me natyrën e veprimtarisë, me vëllimin e saj, me nivelin e vlerësuar të rrezikut për thyerje të kushteve të sigurisë të vlerësuar nga subjekti dhe nga Banka e Shqipërisë etj..
- (2) Brenda zonës së sportelit të zyrës së këmbimit valutor, do të ketë kasafortë metalike, ku të ruhen dhe të administrohen vlerat monetare.
- (3) Krahas zbatimit të kërkesave të paragrafeve (1) dhe (2) të këtij neni, për zhvillimin e veprimtarisë normale, zyra e këmbimit valutor duhet të pajiset me:
 - a) kompjuter;
 - b) tavolinë pune;
 - c) telefon;
 - d) faks;
 - e) makinë të numërimit të parave;
 - f) makinë dhe pajisje të verifikimit të parave;
 - g) tabelë të kurseve të këmbimit;
 - h) modularë për veprimet në sportel dhe për konfirmimin e tyre për klientët;
 - i) tabelë të jashtme në të cilën të shënohet "Zyra e këmbimeve valutore" e pasuar nga emërtimi ligjor (sipas regjistrimit në vendimin e gjykatës);
 - j) të tjera, që subjekti i gjykon të nevojshme.

MBIKËQYRJA

Neni 13

- (1) Verifikimi i zbatimit të këtij udhëzimi i cili përmban standardet minimale në fushën e sigurisë teknike, si rregull do të kryhet nga inspektorët e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe specialistë të Departamentit të Sigurimit

dhe të Mbrojtjes në Bankën e Shqipërisë. Në përfundim të procesit të verifikimit, grupi verifikues do të hartojë raportin përkatës, i cili do t'i shërbejë procesit të vendimmarrjes brenda Bankës së Shqipërisë.

- (2) Gjatë procesit të verifikimit, grupi verifikues mund të mbështetet edhe nga ekspertë të jashtëm në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, sipas një marrëveshjeje të dokumentuar ku të përcaktohen edhe detyrimet në kuadër të ruajtjes së informacionit të rezervuar.

MASAT KORRIGJUESE DHE PENALITETET

Neni 14

- (1) Duke iu referuar nenit (3), paragrafit (3), mosrespektimi i këtyre standardeve minimale nga ana e subjektit, do të vlerësohet si paaftësi e tij për të siguruar kushtet e nevojshme për një veprimtari të sigurtë, e cila mund të shoqërohet me pasoja, që në raste ekstreme mund të çenojnë sigurinë e jetës, mund të dëmtojnë rëndë imazhin e subjektit në publik dhe të çenojnë qëndrueshmërinë e tij.
- (2) Duke iu referuar paragrafit (1), mosrespektimi i standardeve që përmbahen në këtë udhëzim, e bën subjektin objekt të masave korrigjuese dhe të penaliteteve të parashikuara në nenin 44 të ligjit nr.8268 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe në aktet e tjera të Bankës së Shqipërisë të nxjerra në zbatim të tij.

HYRJA NË FUQI

Neni 15

- (1) Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, përcaktimet e tij përfaqësojnë kushte minimale për procesin e licencimit të subjektit (duke përfshirë edhe zgjerimin me degë dhe/ose me agjenci).
- (2) Udhëzimi hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe pritet të zbatohet menjëherë nga subjekti i cili:
 - a. paraqet një kërkesë për t'u licencuar për herë të parë;
 - b. paraqet një kërkesë për të zgjeruar rrjetin ekzistues;
 - c. planifikon të ndryshojë adresë.
- (3) Për të gjitha rastet e tjera të subjekteve ekzistuese, standardet e këtij udhëzimi duhet të plotësohen brenda datës 30 maj 2006.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
ARDIAN FULLANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 103, datë 28.12.2005

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR NËNSHKRIMET E AUTORIZUARA DHE
KUFIJTË E PAGESAVE NË BANKËN E SHQIPËRISË".

Në mbështetje të nenit 43, shkronja "f", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" ndryshuar me ligjin nr. 8384, datë 29.07.1998 dhe me ligjin nr. 8893, datë 25.07.2002 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8269, datë 23.11.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"; nenit 19 të Statutit të Bankës së Shqipërisë miratuar me vendimin nr. 100, datë 19.12.2000 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, ndryshuar me vendimin nr. 84, datë 07.11.2001 dhe të nenit 20 të rregullores "Mbi rregullat proceduriale të Bankës së Shqipërisë" miratuar me vendimin nr. 37, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës, me propozimin e Departamentit Juridik, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për nënshkrimet e autorizuara dhe kufijtë e pagesave në Bankën e Shqipërisë" bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha strukturat në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

RREGULLORE

“PËR NËNSHKRIMET E AUTORIZUARA DHE KUFIJTË E PAGESAVE NË BANKËN E SHQIPËRISË”.

Neni 1

Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) Nënshkrim i autorizuar – është e drejta e Administratorëve dhe e çdo nëpunësi të Bankës së Shqipërisë për të nënshkruar akte juridike dhe/ose korrespondencë.
- b) Kufijtë e përgjegjësive – janë kufijtë e përcaktuar për nënshkrim, në varësi të natyrës dhe të destinacionit të korrespondencës dhe dokumenteve.
- c) Shkalla e përgjegjësive – është përgjegjësia që rrjedh nga ushtrimi i kompetencave nga Administratorët, Inspektori i Përgjithshëm dhe çdo nëpunës i autorizuar për të nënshkruar sipas hierarkisë të përcaktuar nga ligji dhe aktet e tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.
- d) Personel i Bankës së Shqipërisë – janë punonjësit e Bankës së Shqipërisë sipas vendimit nr. 79, datë 31.10.2005 të Këshillit Mbikëqyrës “Për përcaktimin e strukturës organike dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë”.
- e) Autoritet nënshkrues – janë Administratorët dhe nëpunësit e Bankës së Shqipërisë, të cilëve kjo rregullore i jep kompetencë për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë.
- f) Veprim financiar – është çdo lëvizje e fondeve nga llogaritë e Bankës së Shqipërisë.
- g) Kategoritë (A), (B) dhe (C) – janë kategoritë e autoriteteve nënshkruese për efekt të kësaj rregulloreje, bazuar në strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë.

Neni 2

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e shkallës dhe kufijve të përgjegjësive për nënshkrim të Administratorëve dhe të çdo anëtarit të personelit të Bankës së Shqipërisë, si dhe të kufijve të nënshkrimit për kryerjen e veprimeve financiare në shuma monetare.

PJESA I

Kufijtë e përgjegjësive në nënshkrimet e autorizuara.

Neni 3

Kategoritë e nënshkrimeve të autorizuara

1. Autoritetet nënshkruese si dhe shkalla e kufijtë e përgjegjësive të tyre për nënshkrim kushtëzohen nga struktura organizative e Bankës së Shqipërisë. Bazuar në këtë strukturë, e drejta për të nënshkruar kategorizohet si më poshtë:
 - a) Kategoria e parë (A).
 - b) Kategoria e dytë (B).
 - c) Kategoria e tretë (C).
2. Të drejtën e nënshkrimit të kategorisë së parë (A) e kanë:
 - a) Guvernatori.
 - b) Zëvendësguvernatori i Parë dhe Zëvendësguvernatori i Dytë.
 - c) Inspektori i Përgjithshëm
3. Për efekt të kësaj rregulloreje, kanë të drejtën e nënshkrimit të kategorisë së dytë (B):
 - a) Drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e departamenteve në Bankën e Shqipërisë.
 - b) Drejtorët e degëve të Bankës së Shqipërisë dhe zëvendësuesit e tyre.
 - c) Drejtori i Shtypshkronjës së Bankës së Shqipërisë dhe zëvendësuesi i tij.
 - d) Shefi i Kabinetit të Guvernatorit.
4. Kanë të drejtën e nënshkrimit të kategorisë së tretë (C):
 - a) Përgjegjësit e sektorëve dhe përgjegjësit e zyrave, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 79, datë 31.10.2005 "Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë".
 - b) Të gjithë nëpunësit e tjerë, që në strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë përcaktohen si "specialistë" me arsim të lartë.

Neni 4

Kufijtë e nënshkrimeve të autorizuara

1. Në korrespondencën dhe dokumentacionin me të tretë jashtë Bankës së Shqipërisë, të drejtën e nënshkrimit në emër dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë, e kanë vetëm kategoria e parë (A) dhe e dytë (B), në përputhje me këtë rregullore dhe në varësi të natyrës së korrespondencës, të dokumenteve dhe të destinacionit të tyre.
2. Në nënshkrimin e korrespondencës drejtuar të tretëve në emër dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë, synohet të mbahet i njëjti nivel përfaqësimi.
3. Përveç se kur është parashikuar ndryshe në këtë rregullore dhe/ose në aktet e tjera të Këshillit Mbikëqyrës, duhet të mbajnë nënshkrimin e

Guvernatorit:

- a) marrëveshjet dhe dokumentet e tjera të përfaqësimit ligjor me institucionet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare; ose
 - b) dokumentet dhe aktet e tjera, të cilat normojnë marrëdhënie shumëpalëshe me institucione apo me organizma të vendit ose të huaja;
 - c) rekomandimet, opinionet dhe dokumentet e shqyrtuara në komitetet e Bankës së Shqipërisë, në rast se i drejtohen Këshillit Mbikëqyrës;
 - d) urdhërat, udhëzimet, rekomandimet dhe opinionet e lëshuara nga Guvernatori.
4. Përveç se kur është parashikuar ndryshe në aktet e tjera të Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatori nënshkruan, në emër dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë, korrespondencën dhe/ose dokumentet adresuar, kryesisht:
- a) tek Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe në Këshillin e Ministrave;
 - b) tek anëtarët e Këshillit të Ministrave, krerët e Gjykatave, Gjykata Kushtetuese, Prokurori i Përgjithshëm, Kontrolli i Lartë i Shtetit, titullarët e institucioneve të tjera qendrore publike, organizmat ndërkombëtarë dhe trupi diplomatik, për fushën e veprimtarisë që mbulon në bazë të Statutit dhe të akteve të tjera të Këshillit Mbikëqyrës.
5. Zëvendësguvernatorët nënshkruajnë në emër dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë korrespondencën dhe/ose dokumentet adresuar, kryesisht:
- a) subjekteve të tjera të sektorit publik dhe privat për fushën e veprimtarisë që ata mbulojnë në bazë të Statutit dhe të akteve të tjera të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;
 - b) përfaqësuesve të zgjedhur të komunitetit të biznesit, të akademisë dhe të shoqërisë civile etj.;
 - c) zëvendësguvernatorët nënshkruajnë gjithashtu edhe procesverbalet e mbledhjeve të komiteteve në Bankën e Shqipërisë, të kryesuara prej tyre.
6. Drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e departamenteve, Shefi i Kabinetit të Guvernatorit, nënshkruajnë korrespondencën dhe/ose dokumentacionin e adresuar të tretëve, sipas fushës së veprimtarisë së tyre, duke ruajtur të njëjtin nivel përfaqësimi.

Neni 5

Nënshkrimet e autorizuara në rastet e mungesës dhe të pamundësisë për të vepruar

1. Në rastet kur Guvernatori mungon apo është në pamundësi të ushtrimit të funksioneve të tij, në rastet e parashikuara në nenin 3, pika 3 nënshkruajnë Zëvendësguvernatorët.
2. Në rastin kur njëri nga Zëvendësguvernatorët mungon apo është në pamundësi për të ushtruar kompetencat e tij, Zëvendësguvernatori tjetër

merr kompetencat dhe nënshkruan për të gjitha rastet, sipas fushës së veprimtarisë së Zëvendësguvernatorit të zëvendësuar.

3. Drejtuesi me vjetërsinë me të madhe në Bankën e Shqipërisë në shkallën më të lartë të hierarkisë në departamentet e kategorisë së parë, mund të nënshkruajë në rastet e parashikuara në nenin 3, pika 3, kur të gjithë Administratorët mungojnë apo janë në pamundësi për të ushtruar kompetencat e tyre.
4. Nëpunësit me vjetërsi më të madhe në njësinë apo strukturën përkatëse, nënshkruajnë korrespondencën dhe/ose dokumentacionin për çështje sipas fushës së veprimtarisë së njësisë apo të strukturës përkatëse, në çdo rast mungese apo pamundësie të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, për të vepruar edhe në rastin e mungesës së një autorizimi paraprak.
5. Personat e autorizuar si më sipër, duhet të përmendin organin autorizues me nënshkrimin e tyre sipas një udhëzimi të veçantë.

Neni 6

Përdorimi i autorizuar i vulës zyrtare të Bankës së Shqipërisë

1. Dokumentacioni i adresuar të tretëve jashtë Bankës së Shqipërisë, i nënshkruar në emër dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë, nga autoritetet nënshkruese të kategorisë së parë (A) dhe të dytë (B), shoqërohen me vulën zyrtare të Bankës së Shqipërisë.
2. Vula zyrtare e Bankës së Shqipërisë shoqëron gjithashtu, edhe nënshkrimet e nëpunësve të tjerë të Bankës së Shqipërisë të cilët nënshkruajnë, sipas rregullave të kësaj rregulloreje, dokumentacionin adresuar të tretëve jashtë Bankës së Shqipërisë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

PJESA II

Nënshkrimet e autorizuara për kryerjen e veprimeve financiare të Bankës së Shqipërisë.

Neni 7

Kushtet e kryerjes së veprimeve financiare

Veprimet financiare të Bankës së Shqipërisë kryhen me plotësimin dhe respektimin e kushteve të mëposhtme:

- a) Ekzistenca e një akti apo e një dokumenti të shkruar nëpërmjet të cilit buron e drejta për të kryer veprimin financiar (ligj ose akt nënligjor, vendimet, rregulloret dhe aktet e tjera të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, udhëzimet, urdhërat apo aktet e tjera të nxjerra dhe të miratuara nga Administratorët; urdhërat e të tretëve - jashtë Bankës së Shqipërisë - për

fondet e tyre).

- b) Ekzistenca e urdhërit për ekzekutimin e veprimit financiar.

Neni 8

Autoritetet nënshkruese të urdhërit për nisjen e ekzekutimit të veprimit financiar

Urdhëri për nisjen e ekzekutimit të veprimit financiar (të shoqëruar me dokumentacionin mbështetës) për:

- a) shlyerjen e detyrimeve financiare që burojnë drejtpërsëdrejti nga ligji (sigurimet shoqërore, shëndetësore etj.) si dhe për detyrimet financiare që rrjedhin nga ekzistenca e kontratave të furnizimit të vazhdueshëm, të lidhura nga Banka e Shqipërisë me të tretë (të tilla si për shembull, kontratat për sëifin, reuter-in, energjinë elektrike, telefoninë, ujin etj.) nënshkruhet nga autoritetet nënshkruese të kategorisë së dytë (B) në Departamentin e Kontabilitetit dhe Pagesave;
- b) shlyerjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga kontratat apo nga marrëveshjet e lidhura nga Banka e Shqipërisë me të tretë, të ndryshme nga kontratat e përmendura në paragrafin e mësipërm, nënshkruhet nga autoritetet nënshkruese të kategorisë së dytë (B) në Departamentin e Operacioneve Monetare, në Departamentin e Kontabilitetit dhe Pagesave dhe/ose në Departamentin e Administrimit, sipas rastit konkret dhe në përputhje me objektin e veprimtarisë dhe detyrat e secilit prej tyre;
- c) për raste të tjera, që nuk përfshihen në dy paragrafët e mësipërm, urdhëri për ekzekutimin e veprimit financiar nënshkruhet nga Administratorët.

Neni 9

Organet kompetente për ekzekutimin e veprimit financiar

1. Ekzekutimi i veprimit financiar kryhet nga Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave.
2. Përsa nuk parashikohet në këtë rregullore, veprohet në përputhje me përcaktimet e bëra në rregulloret e brendshme të Bankës së Shqipërisë si dhe në manualët e punës dhe manualët e veprimeve financiare.

Neni 10

Libri i nënshkrimeve të autorizuara

1. Libri i nënshkrimeve të autorizuara përmban specimenet (mostrat) e nënshkrimeve të autoriteteve nënshkruese, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.
2. Çdo ndryshim në nënshkrim (si specimen/mostër), në kategorizimin dhe klasifikimin e nënshkrimeve të autorizuara ekzistuese si dhe revokimi i tyre apo vendosja e nënshkrimeve të reja, pasqyrohet në librin e nënshkrimeve

të autorizuar.

3. Çdo nënshkrim i autorizuar (si specimen) është i vlefshëm për sa kohë nuk është ndryshuar. Ndryshimi i nënshkrimit (si specimen) konsiderohet i vlefshëm kur njoftohet me shkrim dhe publikohet.
4. Nënshkrimi i autorizuar (si kategori) është i vlefshëm për sa kohë nuk është njoftuar me shkrim apo publikuar ndryshimi apo revokimi i tij.
5. Departamenti i Burimeve Njerëzore mban dhe administron librin e nënshkrimeve të autorizuar.

Neni 11

Dispozita të fundit

Udhëzimi nr. 404^R, datë 21.02.2002 "Për nënshkrimet e autorizuar dhe limitet e pagesave në Bankën e Shqipërisë", miratuar nga Guvernatori dhe rregullorja "Për nënshkrimet e autorizuar në ushtrimin e kompetencave të Bankës së Shqipërisë" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 07.07.1999, shfuqizohen.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të saj në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
ARDIAN FULLANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 104, datë 28. 12. 2005

PËR MIRATIMIN E "KALENDARIT TË MBLEDHJEVE DHE PROGRAMIT TË
PUNËS SË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR VITIN 2006"

Në mbështetje të nenit 43, pika "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Kalendarin e Mbledhjeve dhe Programin e Punës të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për vitin 2006", sipas anekseve 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e aneksit 1 të këtij vendimi (Kalendari i mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për vitin 2006).
3. Ngarkohen me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi Administratorët dhe të gjitha strukturat e tjera organizative të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

ANEKSI 1

KALENDARI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2006

NR	PROBLEMET KRYESORE, QË DO TË SHQYRTOHEN NGA KËSHILLI MBIKËQYRËS	DATAT E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJES	DATAT E PUBLIKIMIT TË RENDIT DITËS
1	Deklarata e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2005.	25 janar 2006	23 janar 2006
2	Deklarata "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2005".	8 shkurt 2006	6 shkurt 2006
3	Raporti i politikës monetare për muajin janar 2006.	22 shkurt 2006	20 shkurt 2006
4	Analizë e sistemit bankar për tremujorin e katërt të vitit 2005.	15 mars 2006	13 mars 2006
5	Raporti dhe Bilanci Vjetor i Bankës së Shqipërisë për vitin 2005.	29 mars 2006	27 mars 2006
6	Strategjia e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për vitet 2006 – 2008.	12 prill 2006	10 prill 2006
7	Opinionin e Bankës së Shqipërisë "Mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2006".	26 prill 2006	24 prill 2006
8	Struktura dhe gjendja e monedhës në qarkullim në fillim dhe në fund të fitit 2006.	10 maj 2006	8 maj 2006
9	Raporti i politikës monetare për muajin prill 2006.	24 maj 2006	22 maj 2006
10	Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes Bankare për vitin 2005.	14 qershor 2006	12 qershor 2006
11	Raporti i politikës monetare për muajin maj 2006 dhe rishikimi i Programit Monetar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2006.	28 qershor 2006	26 qershor 2006
12	Analizë e sistemit bankar për tremujorin e parë të vitit 2006.	12 korrik 2006	10 korrik 2006
13	Deklarata e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2006.	26 korrik 2006	24 korrik 2006
14	Raporti i politikës monetare për muajin korrik 2006.	30 gusht 2006	28 gusht 2006
15	Analizë e sistemit bankar për tremujorin e dytë të vitit 2006.	13 shtator 2006	11 shtator 2006
16	Raporti i politikës monetare për muajin gusht 2006.	27 shtator 2006	25 shtator 2006
17	Mbi transparencën e bankave të nivelit dytë.	11 tetor 2006	9 tetor 2006
18	Opinionin e Bankës së Shqipërisë "Mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2006".	25 tetor 2006	23 tetor 2006
19	Miratimi i Programit Monetar dhe i planit të buxhetit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007.	15 nëntor 2006	13 nëntor 2006
20	Raporti i politikës monetare për muajin tetor 2006.	30 nëntor 2006	27 nëntor 2006
21	Miratimi i Programit Monetar dhe i Dokumentit të Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007.	13 dhjetor 2006	11 dhjetor 2006
22	Raporti i politikës monetare për muajin nëntor 2006.	27 dhjetor 2006	25 dhjetor 2006

NDREQJE GABIMI:

NË RREGULLOREN “MBI TREGUN SEKONDAR NDËRBANKAR TË LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” miratuar me vendimin nr. 84, datë 16.11.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe publikuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë: vëllimi 7, numër 15, nëntor 2005 bëhen korrigjimet e mëposhtme:

- Neni 2, në paragrafin e dytë, faqe 5 e buletinit të lartpërmendur:
Është: “Treg sekondar”, bëhet “Treg sekondar ndërbankar”.
- Titulli, PJESA II, faqe 6 e buletinit të lartpërmendur:
Është: “Tregu sekondar i letrave me vlerë të qeverisë”,
Bëhet: “Tregu sekondar ndërbankar i letrave me vlerë të qeverisë”.
- Në fillim të nenit 3, faqe 6 e buletinit të lartpërmendur:
Është: “Treg sekondar”, bëhet “Treg sekondar ndërbankar”.

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 1, SHKURT 2005

1. Vendim nr.01, datë 26.01.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2004".
2. Vendim nr.02, datë 26.01.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri".
3. Vendim nr.03, datë 26.01.2005 "Për një ndryshim në rregulloren "Për dhënien e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë".
4. Vendim nr.04, datë 26.01.2005 "Për caktimin e afateve të plotësimit të kërkesës për rritjen e kapitalit të kërkuar të bankave".
5. Vendim nr.08, datë 26.01.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun të Bankës së Shqipërisë".
6. Vendim nr.09, datë 26.01.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike në Bankën e Shqipërisë".
7. Vendim nr.10, datë 26.01.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike në Bankën e Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 2, SHKURT 2005

1. Vendim nr.11, datë 09.02.2005 "Për miratimin e dokumentit për misionin e mbikëqyrjes".
2. Vendim nr.12, datë 09.02.2005 "Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, të bankës së propozuar "Union Bank" sh.a.".
3. Vendim nr.13, datë 09.02.2005 "Për miratimin e kontratës - tip për marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të letrave me vlerë".
4. Vendim nr.14, datë 09.02.2005 "Për miratimin e rregullores për dhënien e kredive për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 3, SHKURT 2005

1. Vendim nr.15, datë 23.02.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin janar të vitit 2005".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 4, PRILL 2005

1. Vendim nr.18, datë 09.03.2005 "Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhave përkujtimore, që do të shtypen për qëllime numizmatike, në vitin 2005".
2. Vendim nr.19, datë 09.03.2005 "Për mënyrën e vlerësimit të vlerave numizmatike pa kosto në Bankën e Shqipërisë".

3. Vendim nr.22, datë 09.03.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës të Bankës së Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 5, PRILL 2005

1. Vendim nr.24, datë 30.03.2005 "Për uljen e përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim nr.27, datë 30.03.2005 "Për shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, për vitin 2006".
3. Vendim nr.28, datë 30.03.2005 "Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 6, MAJ 2005

1. Vendim nr. 30, datë 27.04.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin mars të vitit 2005".
2. Vendim nr. 31, datë 27.04.2005 "Për një ndryshim në rregulloren për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare".
3. Vendim nr. 32, datë 27.04.2005 "Për miratimin e sistemit raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare".
4. Vendim nr. 33, datë 27.04.2005 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 25, datë 01.04.2003 për miratimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003".
5. Vendim nr. 35, datë 27.04.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat dhe shpenzimet e daljes jashtë shtetit për shërbim, kualifikim etj., të punonjësve dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 7, MAJ 2005

1. Vendim nr. 36, datë 19.05.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat e shtypjes, të rishtypjes dhe të emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim nr. 38, datë 19.05.2005 "Për miratimin e rregullores mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore".
3. Vendim nr. 40, datë 19.05.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave të Bankës së Shqipërisë".
4. Vendim nr. 41, datë 19.05.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave të Bankës së Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 8,
QERSHOR 2005

1. Vendim nr. 42, datë 08.06.2005 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005".
2. Vendim nr. 43, datë 08.06.2005 "Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim - kreditit dhe unioneve të tyre".
3. Vendim nr. 44, datë 08.06.2005 "Për miratimin e sistemit raportues për shoqëritë e kursim - kreditit dhe të unioneve të tyre".
4. Vendim nr. 45, datë 08.06.2005 "Për disa ndryshime në udhëzimin për kapitalin rregullator të Bankës së Shqipërisë".
5. Vendim nr. 46, datë 08.06.2005 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren për mjaftueshmërinë e kapitalit".
6. Vendim nr. 47, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga fondet për rindërtimin e Kosovës tek Fonds der Republik der Kosova, Gjermani".
7. Vendim nr. 48, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga Fonds der Republik der Kosova, Gjermani tek Francesco Mariano Mariano dhe Banca Popolare Pugliese (Banka Popullore Pulieze)".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 9,
QERSHOR 2005

1. Vendim nr. 49, datë 29.06.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin maj të vitit 2005".
2. Vendim nr. 51, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores për procedurat e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)".
3. Vendim nr. 52, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për funksionimin e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH".
4. Vendim nr. 53, datë 29.06.2005 "Për "miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH".
5. Vendim nr. 54, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS".
6. Vendim nr. 55, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat e brendshme të funksionimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 10,
KORRIK 2005

1. Vendim nr. 56, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Mbi transaksionet e shitbjeve me të drejta të plota".
2. Vendim nr. 57, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë lombard".

3. Vendim nr.58, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për depozitën njëditore"".
4. Vendim nr. 59, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë njëditore"".
5. Vendim nr. 60, datë 13.07.2005 "Për vendosje komisioni në sportelet e Bankës së Shqipërisë për bonot e thesarit".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 11, GUSHT 2005

1. Vendim nr.66, datë 28.07.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2005".
2. Vendim nr. 67, datë 28.07.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri".
3. Vendim nr.68, datë 28.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për mbikëqyrjen e konsoliduar".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 12, SHTATOR 2005

1. Vendim nr.70, datë 31.08.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin korrik të vitit 2005".
2. Vendim nr. 71, datë 31.08.2005 "Për miratimin e udhëzimit "Mbi mënyrën e llogaritjes së "fiksit" të kursit të këmbimit të lekut, në Bankën e Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 13, TETOR 2005

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 77, datë 12.10.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin gusht të vitit 2005".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 12.10.2005 "Për miratimin e përmbajtjes dhe konfigurimeve të vizatimeve të monedhës që do të shtypet për qëllime numizmatike në vitin 2006".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 14, NËNTOR 2005

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 31.10.2005 "Për caktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 80, datë 01.11.2005 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2005".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 83, datë 01.11.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit Juridik të Bankës së Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 15,
NËNTOR 2005

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 84, datë 16.11.2005 "Për miratimin e rregullores "Mbi tregun sekondar ndërbankar të letrave me vlerë të Qeverisë të Republikës së Shqipërisë".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 87, datë 16.11.2005 "Për shfuqizimin e vendimit nr. 26, datë 29.03.2000 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 88, datë 16.11.2005 "Për një ndryshim në rregulloren "Për licencimin e subjekteve jobanka".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 89, datë 16.11.2005 "Për disa ndryshime në udhëzimin "Për blerjet dhe shërbimet në vlerë të vogël në Bankën e Shqipërisë".
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 90, datë 16.11.2005 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe të ndërtimeve në Bankën e Shqipërisë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 16,
NËNTOR 2005

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.91, datë 30.11.2005 "Për miratimin e "Raportit të Politikës Monetare për muajin tetor të vitit 2005".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.92, datë 30.11.2005 "Për miratimin e rregullores "Mbi kredinë brenda ditës për bankat e nivelit të dytë".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 7, NUMËR 17,
DHJETOR 2005

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.94, datë 14.12.2005 "Për miratimin e disa ndryshimeve në formularët e Sistemit Raportues të Unifikuar".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.95, datë 14.12.2005 "Për shtesën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve të punës në Bankën e Shqipërisë".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.96, datë 14.12.2005 "Për lirimin e zotit Limos Malaj nga detyra e Zëvendësguvernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë".

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.

Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;

Faks : 355-4-223558

www.bankofalbania.org

E-mail: public@bankofalbania.org

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.

Tirazhi : 320 kopje